



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

Raporti Gjashtëmuor (Janar - Qershor) 2019 - Zbatimi i Strategjisë për Reformën e Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP) të Kosovës 2016-2020.

Prishtinë
2019

PËRMBAJTJA

| | |
|---|----|
| SHKURTESAT | 3 |
| HYRJE | 4 |
| PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | 5 |
| 1. RAPORTI I PËRGJITHSHËM SIPAS SHTYLLAVE | 12 |
| 1.1 SHTYLLA 1: DISIPLINA FISKALE | 12 |
| PRIORITETI 1: SAKTËSIA E PARASHIKIMIT TË INDIKATORËVE MAKROEKONOMIK DHE TË HYRAVE: | 12 |
| PRIORITETI 2: KONTROLLET EFEKTIVE TË ZOTIMEVE | 13 |
| PRIORITETI 3: MBLEDHJA E QËNDRUESHME E TË HYRAVE | 14 |
| 1.2 SHTYLLA 2: EFIKASITETI ALOKUES | 16 |
| PRIORITETI 4: ZHVILLIMI I KORNIZËS AFATMESME TË SHPENZIMEVE (KASH) | 16 |
| PRIORITETI 5: BESUESHMËRIA DHE KONTROLLI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT VJETOR | 17 |
| PRIORITETI 6: CILËSIA E INFORMATAVE TË BUXHETIT KAPITAL | 18 |
| 1.3 SHTYLLA 3: EFIKASITETI OPERACIONAL | 19 |
| PRIORITETI 7: PROKURIMI PUBLIK | 19 |
| PRIORITETI 8: FUQIZIMI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM | 20 |
| PRIORITETI 9: FUQIZIMI I AUDITIMIT TË JASHTËM | 22 |
| 1.4 SHTYLLA 4: ÇËSHTJET E NDËRLIDHURA TË MFP | 23 |
| PRIORITETI 10: PËRMIRËSIMI I SISTEMEVE TË TI | 23 |
| PRIORITETI 11: TRANSPARENCA PËR BUXHETIN | 24 |
| PRIORITETI 12: NGRITJA E QËNDRUESHME E KAPACITETEVE NË MFP | 25 |
| ANEKS 1. SHPJEGIM I DETAJUAR MBI ZBATIMIN E SECILIT AKTIVITET | 26 |

SHKURTESAT

AB - Auditimi i Brendshëm
ATK - Administrata Tatimore e Kosovës
BB - Banka Botërore
BDMS - (Budget Development and Management System) - Sistemi i Zhvillimit dhe Menaxhimit të Buxhetit
BE - Bashkimi Evropian
BQK - Banka Qendrore e Kosovës
DIEKP - Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave
FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtare
GDPS - Grupi Drejtues për Planifikim Strategjik
IPSAS - (International Public Sector Accounting Standards) - Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik
ISSAI- SNISA- (International Standards of Supreme Audit Institutions) Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
KASH - Korniza Afatmesme e Shpenzimeve
KBFP - Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike
KRPP - Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
LMFPP - Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
MF - Ministria e Financave
MFP - Menaxhimi i Financave Publike
GK MFP - Grupi Koordinues i Menaxhimit të Financave Publike
NjQH - Njësia Qendrore Harmonizuese
OB - Organizatat Buxhetore
PIP - Programi i Investimeve Publike
SFQ (GFS)-FMNS - Statistikat Financiare Qeveritare
SIGMA - (Support for Improvement in Governance and Management) - Përkrahje për Përmirësim në Qeverisje dhe Menaxhment
SIMFK - Sistemi Informativ i Menaxhimit të Financave të Kosovës
SKZH - Strategjinë Kombëtarë për Zhvillim
SRMFP - Strategjia për Reformën e MFP
TI - Teknologjia e Informacionit
TVSH - Tatimi në Vlerën e Shtuar
VNB - Vlerësimi i Ndikimit Buxhetor
ZKA - Zyra Kombëtare e Auditorit

HYRJE

Ky raport përmbledh dhe paraqet arritjet e prioriteteve dhe progresin në aktivitete të Strategjisë së Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP) gjatë gjashtëmuajt të parë të vitit 2019. Këtë vit, për dallim nga raportet e mëparshme, raporti shqyrton zbatimin e planit të rishikuar të Veprimit për vitet 2019-2020 për periudhën kohore janar Qershor 2019. Hartimi i raportit monitorues gjashtëmuajt ka për qëllim shqyrtimin e progresit të arritur në zbatimin e aktiviteteve të strategjisë si dhe identifikimin e sfidave. Për më shumë ky raport ka karakter informues me qëllim të identifikimit të problemeve në zbatim të strategjisë si dhe adresimin me kohë të tyre.

Sipas mandatit të dhënë me Vendimin e Ministrit, Nr. 33/2018, Grupi Koordinues për MFP obligohet të përgatisë raporte të rregullta vjetore dhe gjashtëmuajtore. Pas finalizimit të raportit vjetor për vitin 2018, ky është raporti i tretë gjashtëmuajt i cili paraqet progresin e arritur në realizimin e aktiviteteve të planifikuara për zbatim gjatë vitit 2019.

Qasja e adoptuar në përgatitjen e raportit gjashtëmuajt ka qenë një kombinim i takimeve dhe konsultimeve në mes të Sekretariatit (DIEKP/MF) dhe bartësve kryesorë të secilit prioritet. Fillimisht është përgatitur tabela raportuese (e bazuar në udhëzimet e OECD/SIGMA) dhe mbi bazën e informacioneve të dhëna nga bartësit kryesorë është përpiluar fillimisht Raporti Tabelar gjashtëmuajt për vitin 2019.

Në fund të vitit 2018 është bërë rishikimi afatmesëm i Planit të Veprimit për periudhën kohore 2019-2020 dhe ndryshimet e bëra janë reflektuar në Strategjinë e Reformës së Menaxhimit të Financave Publike (SRMFP) 2016-2020. Me qëllim të ruajtjes së cilësisë dhe vazhdimësisë, bazuar në analizat dhe diskutimin e gjerë me akterët relevant, Shtyllat dhe Prioritetet e SRMFP kanë mbetur të njëjta. Në disa raste, bazuar në relevancën, janë rishikuar Objektivat e prioriteteve, Indikatorët për matjen e arritjes së objektivit si dhe Aktivitetet. Vlen të theksohet se Plani i Veprimit 2019-2020 karakterizohet me numër më të vogël të aktiviteteve (50) por me numër më madh të Pikave të referimit (68 për vitin 2019) që siguron zbatimin dhe arritjen më të mirë të Prioriteteve.

SRMFP është ende e ndërtuar mbi 4 shtylla dhe 12 prioritete që përfshijnë të gjithat fushat e reformës së Menaxhimit të Financave Publike. Në vijim raporti shpalosë zbatimin e aktiviteteve brenda secilit prioritet të definuar me Planin e veprimit 2019-2020 të SRMFP-së. Po ashtu aty ku ka qenë e mundur raportimi është bërë edhe në nivel të indikatorëve. Raportimi i plotë mbi arritjen e tyre do të bëhet në raport vjetor.

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Raporti i tretë gjashtëmujor i zbatimit të Strategjisë për Reformën e MFP evidenton progres të arritur në shumicën e aktiviteteve të parapara. Bazuar në raportet e pranuar nga strukturat përgjegjëse, nga **dyzetënëntë (49)** aktivitetet e planifikuara, me **gjashtëdhjetetë (68)** Pika të Referimit, raportohet se:

- Në **katërdhjetë e gjashtë (46) aktivitete** është shënuar progres në zbatim apo ka filluar zbatimi pa vonesa.
- Në **dy (2) aktivitete** nuk është raportuar progres apo janë evidentuar vonesa në fillim të zbatimit.
- Ndërsa **një (1) aktivitet** planifikohet të zbatohet pas vitit 2019 (nuk ka Pikë Referimi për vitin 2019).

Vlen të theksohet se nga analiza e bërë del se janë tri (3) aktivitete të përfunduara që tash në periudhën e parë të vitit 2019 (2.2, 9.3 dhe 11.3) si dhe janë identifikuar gjashtë (6) Aktivitete si sfiduese përkundër përpjekjeve të deritashme (2.8, 3.3, 5.2, 7.6, 11.2 dhe 12.1).

PROGRESI I PËRGJITHSHËM

Në shtyllën e parë Disiplina Fiskale, gjatë vitit 2019 janë të planifikuara të zbatohen gjithsej nëntëmbëdhjetë (19) aktivitete me njëzetetë (23) Pika të Referimit, të ndara në tri Prioritete kryesore:

- 1.- Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave,
- 2.- Kontrollat efektive të zotimeve dhe
- 3.- Mbledhja e Qëndrueshme e të hyrave.

Bazuar në raportet e strukturave përgjegjëse, gjatë periudhës gjashtëmujore, nga nëntëmbëdhjetë (19) aktivitetet e planifikuara raportohet se në shtatëmbëdhjetë (17) prej tyre është shënuar progres në zbatim apo ka filluar zbatimi pa vonesa, për një (1) aktivitet nuk është raportuar progres apo janë evidentuar vonesa në fillim të zbatimit, kurse një (1) aktivitet planifikohet të zbatohet pas vitit 2019 (nuk ka Pikë Referimi për vitin 2019).

Tek **Prioriteti i parë**, Saktësia e Parashikimit të Indikatorëve Makroekonomik dhe të Hyrave, përmes aktiviteteve të ndërmarra mund të raportojmë se kemi progres në indikatorin e parë. Është ruajtur trendi i parashikimit të kujdesshëm dhe real i të hyrave tatimore. Shmangia mesatare e të hyrave të realizuara në krahasim me parashikimin e të hyrave tatimore, sipas raportit preliminar, është -2.4%, që siguron arritjen e Pikës së Referimit për vitin 2019 (-6% deri 12%) si dhe cakun në vitin 2020. Zbatimi i aktiviteteve të parapara me rishikimin e Planit të Veprimt 2019-2020 të SRMFP është duke shkuar sipas Pikave të Referimit pa vonesa.

Gjithashtu tek **Prioriteti i dytë**, Kontrollat efektive të zotimeve, është arritur progres në zbatimin e aktiviteteve. Gjatë periudhës raportuese janë hartuar një sërë aktesh normative që kanë forcuar monitorimin e OB-ve dhe zbatimin e Ligjit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike (KBFP). Lidhur me risitë e dala nga Ligji për KBFP janë trajnuar zyrtarët relevant për zbatimin e ligjit. Është duke shkuar sipas planit monitorimi i Subjekteve të Sektorit Publik (SSP). Përshkrimi i proceseve, standardi unik i menaxhimit

të rrezikut, i përkrahur nga USAID, ka filluar të zbatohet përmes pilot projekteve të nivelit lokal. Në Qershor 2019 është hartuar dhe aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK) Raporti i konsoliduar vjetor për funksionimin e sistemit të KBFP-së (MFK+AB) për vitin 2018.

Për sa i përket **Prioritetit të tretë**, Mbledhja e Qëndrueshme e të Hyrave, sipas të dhënave të grumbulluara del se për dy Indikatorët e rishikuar kemi rezultate të mira. Është shënuar rritje e numrit të tatimpaguesve që i deklarojnë të ardhurat në mënyrë vullnetare në 63,327 (67,702 Pika e referimit për vitin 2019). Gjithashtu kemi ulje të nivelit të borxhit tatimor si përqindje e të hyrave totale vjetore (Indikatori nga SBS) në 29.5% (29% Pika e Referimit për vitin 2019). Progres është shënuar edhe në ngritjen e përmbushjes së deklaramit me kohë, si rezultat i përdorimit të modulit për Menaxhimin e mos-deklaruesve në TVSH si dhe funksionalizimin e Njesisë për trajtimin e mos deklaruesve dhe deklaruesve me vonesë. Progresi është evidentuar edhe në përshpejtimin e rimbursimit të TVSH-së nga 30 ditë sa ishte në periudhën Janar-Qershor 2018, në 23 ditë në periudhën Janar-Qershor 2019, pra për shtatë (7) ditë më shpejtë. Kanë përfunduar përgatitjet për sistemin e kontrollimit me Barcode - RFID, ku së shpejti pritet funksionalizimi i tij. Janë ngritur kapacitetet e Doganës së Kosovës (DK) për mbledhjen e qëndrueshme të të hyrave përmes trajnimit të 117 zyrtarëve doganorë. Si rezultat i kapaciteteve të ngritura në zbatimin e Ligjit të ri Nr. 06/L-005 të Tatimit në Pronën e Paluajtshme, të hyrat nga tatimi në pronë gjatë periudhës Janar-Qershor 2019 kanë shënuar një rritje prej 1,264,691.00 Euro, apo 9% më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit 2018.

Në shtyllën e dytë Efikasiteti Alokues, gjatë vitit 2019 janë të planifikuara të zbatohen gjithsej tetë (8) aktivitete me dymbëdhjetë (12) Pika të Referimit, të ndara në tri prioritetet kryesore. Zbatim i kënaqshëm raportohet në të tri Prioritetet e shtyllës së dytë:

4.- Zhvillimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH)

5.- Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor

6.- Cilësia e informatave të buxhetit kapital

Bazuar në raportet e strukturave përgjegjëse, gjatë periudhës gjashtëmujore, nga tetë (8) aktivitete e planifikuara është shënuar progres në zbatim apo ka filluar zbatimi pa vonesa në të tetë (8) aktivitete. Gjatë periudhës raportuese është arritur avancimi i mëtejshëm i rolit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), është fuqizuar besueshmëria e buxhetit vjetor, si dhe është arritur menaxhim më efikas dhe më efektiv i planifikimit dhe monitorimit të investimeve publike.

Tek **Prioriteti i katërt**, Zhvillimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), raportohet se, duke u bazuar në pikën e referimit për vitin 2019 që është 6.50 %, nuk është arritur progres në arritjen e Pikës Referuese tek indikatorin. Mirëpo duke marrë për bazë vitet paraprake ku shmangia ka qenë më e lartë (p.sh në 2017 ka qenë 22.03 %) ka arritje pozitive në uljen e % së shmangies në mes të kufirit të dhënë me KASH - 2019 dhe Buxhetit të aprovuar për vitin 2019 prej vetëm 8.97%. Ky progres është arritur falë ngritjes së kapaciteteve të OB në Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor (VNB) të nismave të reja

qeveritare si dhe përmes sigurimit të hartimit të KASH bazuar në Deklaratën e Prioriteteve të Qeverisë. Në opinionet e vlerësimit të ndikimit buxhetor kërkohet si shtesë edhe deklarimi lidhur me korrektësinë e paraqitjes së të dhënave nga ana e OB në formular të VNB.

Prioriteti i pestë, për sa i përket dy indikatorëve, në indikatorin e dytë Numri i transfereve gjatë vitit fiskal raportohet të ketë progres të theksuar. Janë vetëm 26 transfere gjatë gjashtëmujorit të parë 2019 krahasuar me 140 të paraparë si Pikë e Referimit për vitin 2019. Në kuadër të këtij prioriteti janë planifikuar dy (2) aktivitete. Në lidhje me udhëzimin administrativ (UA) për transferimet/ri-alokimet, është hartuar Draft UA dhe pritet të aprovohet së shpejti dhe me ndihmën e GIZ të filloj trajnimi i zyrtarëve në OB për zbatimin e këtij UA. Ndërsa pritet që në pjesën e dytë të vitit të formohet Grupi punues për hartimin e Dokumentit analitik për menaxhimin e performancës.

Prioriteti i gjashtë gjithashtu raportohet të ketë pasur performancë shumë të mirë për sa i përket dy indikatorëve. Numri i ri-alokimeve për OB të nivelit qendror rezulton të kenë qenë vetëm 10 rialokime, që krahasuar me Pikën e Referimit për vitin 2019 është rezultat shumë i mirë. Gjithashtu indikatorin e dytë - Ruajtja e nivelit të shpenzimeve kapitale të planifikuara në raport me strukturën e shpenzimeve të përgjithshme, është i kënaqshëm me 33.1% (33% Pika e Referimit për 2019). UA për kriteret përzgjedhëse dhe prioritizimin e projekteve kapitale është draftuar, pas aprovimit që pritet në pjesën e dytë do të fillohet me ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve relevant. Trajnimet lidhur me PIP janë mbajtur në nivel qendror. Në pjesën e dytë do të mbahen trajnimet për nivelin lokal dhe sipas kërkesës së OB. Udhëzimit Administrativ (UA) për definimin e projekteve kapitale është hartuar gjithashtu nga Grupi Punues. Pas aprovimit do të fillojnë edhe trajnimet e nevojshme.

Në shtyllën e tretë të strategjisë Efikasiteti funksional, raportohet se aktivitetet që kanë të bëjnë me fushën e prokurimit, janë duke u realizuar konform planit. Gjatë vitit 2019 janë të planifikuara të zbatohen gjithsej pesëmbëdhjetë (15) aktivitete me njëzetënjë (21) Pika të Referimit, të ndara në tri Prioritete kryesore:

7.- Prokurimi Publik,

8.- Fuqizimi i auditimit të brendshëm dhe

9.- Fuqizimi i auditimit të jashtëm.

Bazuar në raportet e strukturave përgjegjëse, gjatë periudhës gjashtëmujore, nga pesëmbëdhjetë (15) aktivitetet e planifikuara raportohet se të gjitha aktivitetet kanë shënuar progres në zbatim apo ka filluar zbatimi pa vonesa.

Tek **Prioriteti i shtatë**, është vazhduar të ndërmerren veprimet e nevojshme me qëllim të ngritjes së përdorimit efikas dhe transparent të fondeve publike. Korniza rregullative është finalizuar përfshirë aprovimin e UA për prokurimet e centralizuara për vitin 2019 dhe Plotësim-ndryshimin e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP). Grupi Punues ka punuar në draftimin e Koncept Dokumentit (KD) për trajtimin e legjislacionit në fushën e Prokurimit Publik, që pritet të aprovohet në pjesën e dytë të vitit. Agjencioni Qendror i Prokurimit (AQP) ka punësuar tre zyrtar të rinj, ndërsa pjesa tjetër prej tre zyrtarëve të planifikuar do të përzgjidhen deri në fund të vitit.

Prioriteti i tetë, po ashtu ka shënuar progres të kënaqshëm në zbatim gjatë gjysmës së parë 2019. Indikatorit i parë - Përqindja (%) e auditorëve të brendshëm të certifikuar, ka arritur vlerën 93% (80% Pika e Referimit për vitin 2019). Ka filluar zbatimi i metodologjisë për monitorimin e NjAB, të harmonizuar me kërkesat e reja të Ligjit dhe akteve nënligjore për KBFP. Janë monitoruar tetë (8) NjAB dhe një është në proces të monitorimit. Ngritja e kapaciteteve është bërë përmes konferencës për 'Fuqizimin e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike - llogaridhënia menaxheriale', Programin për certifikim të auditorëve të brendshëm, trajnimeve të mbajtura në IKAP si dhe punëtorive në nivel lokal (me mbi 400 pjesëmarrës).

Prioriteti i nëntë, i shtyllës së tretë merret me auditimin e jashtëm dhe rezultati kryesor është zhvillimi i një institucioni suprem të auditimit. Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore është raportuar progres në zbatimin e të gjitha aktiviteteve. Për më shumë aktiviteti 9.3 është përfunduar. Vlen të theksohet se në kuadër të indikatorit të parë, Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP) ka mbajtur 8 mbledhje ku janë shqyrtuar 5 raporte të auditimit. ZKA ka hartuar koncept dokumentin i cili përmbledh çështjet me rëndësi për adresim në fushën e ruajtjes së pavarësisë institucionale. Softueri i auditimit, për avancimin e metodologjisë së auditimit, është në proces të tenderimit. Janë përditësuar në pajtim me SNISA dhe në zbatim Doracaku i auditimeve të rregullsisë si dhe Udhëzuesi për menaxhimin e cilësisë, ndërsa Manuali i auditimit të performancës është në proces të përditësimit. Deri më tash janë publikuar 4 auditime të performancës. Bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës është konkretizuar me dy konferenca rajonale. Raporti gjashtëmujor i planit të zbatimit të rekomandimeve të ZKA për vitin 2017 është hartuar ndërsa Plani i Veprimit për zbatim të rekomandimeve të Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2017 është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin nr. 08/69 më datë 16.10.2018. Bazuar në Raportet individuale të Auditimit të publikuara për vitin 2018, paraqitet progresi në zbatimin e rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit për vitin 2017. Pas përpunimit të dhënave, rezultatet do të prezantohen në Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2018, i cili publikohet në muajin gusht 2019.

Në shtyllën e katërt të strategjisë Çështjet e ndërlidhura me MFP, raportohet se shtatë (7) aktivitetet me dymbëdhjetë (12) pika të referimit, të parapara me rishikim, janë duke u realizuar konform planit. Aktivitetet e planifikuara janë të ndara në tri Prioritete kryesore:

- 10.- Përmirësimi i sistemeve të TI,
- 11.- Transparenca për buxhetin dhe
- 12.- Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP.

Tek **Prioriteti i dhjetë**, raportohet se indikatorit tashmë ka arritur Pikën e Referimit për vitin 2020, Integrimi i sistemeve në MF dhe Agjencitë e saj vartëse ka përfunduar dhe është funksional. Është duke u punuar në përmirësimin e mëtejshëm të sistemeve të TI-së. Zhvillimi i DWH (Data warehouse) dhe sistemit raportues (BI-Business Intelligence) është në vijim e sipër. Qendra e të dhënave financiare (Disaster Recovery System) është

kompletuar me pajisje dhe në pjesën e dytë të vitit do të punohet në sinkronizim me kapacitete të plota.

Prioriteti i njëmbëdhjetë ka shënuar gjithashtu progres në sigurimin e transparencës së shpenzimit të fondeve publike duke siguruar pajtueshmërinë e informatave për Buxhetin e Kosovës me standardin 2014 GFSM. Gjatë periudhës raportuese janë krijuar formula specifike për gjenerimin e raporteve kristale në SIMFK. Për sa i përket planit kontabël, pritet që në pjesën e dytë të vitit të rishikohet sipas kërkesave të reja të IPSAS dhe pas kësaj të fillohet me trajnimin e Zyrtarëve Kryesor Financiarë të OB-ve. MF ka vazhduar me hartimin e Dokumentit të Buxhetit Miqësor (Narrativ) për vitin 2019 në të tri gjuhët i cili është publikuar në ueb faqen e MF-së në Prill 2019 (<https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,132>). Gjithashtu janë përgatitur Raporti vjetor financiar për vitin 2018, Raporti tremujor dhe Raporti gjashtëmujor i buxhetit 2019. Raportimi është duke u bërë në vazhdimësi në Portalin e Transparencës (<https://ptmf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,1>).

Tek Prioriteti i dymbëdhjetë, raportohet se janë siguruar mjetet nga buxheti i Kosovës për Studimin e fizibilitetit për opsionin më të mirë të ngritjes së kapaciteteve në fushën e MFP. Gjatë periudhës kohore Janar-Qershor 2019 janë ndërmarr disa iniciativa, të cilat nuk kanë rezultuar me zbatimin e studimit të Fizibilitetit. Në pjesën e dytë të vitit pritet që të sigurohet ekspertiza për kompletimin e dokumentacionit tenderues dhe të tenderohet kërkesa për studim të fizibilitetit. Vlerësimi i nevojave për trajnim në fushën e MFP-së parashihet të realizohet si pjesë e studimit të fizibilitetit.

PROBLEMET DHE RREZIQET - SFIDAT

REZIQET - Raporti konstaton se shumica e Aktiviteteve (47) janë duke u zbatuar konform planit, ndërsa dy (2) Aktivitete me ngecje apo vonesë në zbatim.

Vlen të theksohet se përkundër vonesës në zbatimin e dy aktiviteteve në fjalë (Aktivitetet 1.2 dhe 5.1) raporti evidenton progres në arritjen e Indikatorëve të Prioritetit 1 dhe 5, pasi ka qenë e mundur sigurimi i vlerave të indikatorëve për matjen e tyre.

Në shtyllën e parë Disiplina Fiskale, nga gjithsej nëntëmbëdhjetë (19) Aktivitete me njëzetetë (23) Pika të Referimit, në një (1) Aktivitet nuk është raportuar progres apo janë evidentuar vonesa në fillim të zbatimit. **Aktiviteti 1.2.- Publikimi i metodologjisë së hartimit të parashikimeve ekonomike**, për shkak të kompleksitetit si dhe ndërlikohjes me proceset buxhetore është identifikuar si sfidues. Metodologjia e hartimit të parashikimeve ekonomike pritet të publikohet pas miratimit të Buxhetit për vitin 2020.

Në shtyllën e dytë Efikasiteti Alokues, nga gjithsej tetë (8) Aktivitete, për një (1) Aktivitet nuk është raportuar progres apo është evidentuar vonesë në fillim të zbatimit. **Aktiviteti.-5.1 Zbatimi i Udhëzimit Administrativ (UA) për transferimet - ri-alokimet**, nuk ka filluar të zbatohet pasi që për shkak të ndërlikohjes me Ligjin e Buxhetit, pritet të aprovohet nga Ministri për të hyrë në fuqi në vitin 2020. UA është hartuar nga GP dhe

me aprovimin e tij do të filloj mbajtja e trajnimeve të nevojshme për zyrtarët e OB-ve gjatë tremujorit të katërt (K4) 2019. Ngritja e kapaciteteve, si masë korrigjuese, do të ndërmerret para hyrjes në fuqi të UA në fjalë.

SFIDAT - Nga gjithsejtë dyzetenëntë (49) Aktivitete, si sfiduese janë identifikuar gjashtë (6) si në vijim:

- 2.8 Hartimi i infrastrukturës ligjore për rregullimin e zotimeve tre-vjeçare.
- 3.3 Modernizimi i sistemit të teknologjisë informative.
- 5.2 Hartimi i dokumentit analitik për menaxhimin e performancës.
- 7.6 Trajnimi i zyrtarëve të prokurimit publik në nivel bazik dhe të avancuar.
- 11.2 Rishikimi i planit kontabël të Qeverisë.
- 12.1 Zhvillimi i studimit të fizibilitetit mbi Qendrën e Trajnimeve për MFP, përfshirë vlerësimin e nevojave për trajnime.

Në vijim do të paraqiten hapat e ardhshëm për Aktivitetet e identifikuar si sfiduese për zbatim, sipas Pikave të Referimit, deri në fund të vitit 2019.

HAPAT E ARDHSHËM

Në pjesën e fundit të Raportit¹ është prezantuar në mënyrë detale progresi si dhe hapat e ardhshëm në zbatimin e Aktiviteteve të Planit të Veprimit të SRMFP për gjashtë mujorin e parë të vitit 2019. Në këtë pjesë janë të renditura gjendja dhe hapat e ardhshëm për ato aktivitete të cilat janë vlerësuar si sfiduese. Përshkrimi i aktivitetit përcillet me hapat e ardhshëm të paraparë me qëllim të eliminimit të çështjeve sfiduese. Nga gjithsejtë dyzetenëntë (49) Aktivitete, si sfiduese janë identifikuar gjashtë (6) si më poshtë:

Aktiviteti 2.8.- Vlerësohet si sfidues, edhe pse Thesari ka testuar infrastrukturën në kuadër të SIMFK dhe përkrahet zotimi i fondeve për periudhë 3 vjeçare, por kërkohet avancim në Ligjin e buxhetit duke definuar bazën ligjore për zotime tre vjeçare. Për këtë qëllim kërkohet angazhim dhe vendim marrje me qëllim të plotësim/ndryshimit të Infrastrukturës ligjore, si Pikë e Referimit për vitin 2019. Kjo do të mundësonte Zbatimin e zotimeve tre-vjeçare si Pikë e Referimit e paraparë për vitin 2020.

Aktiviteti 3.3.- Projekti për Modernizimin e sistemit të teknologjisë informative kudo është kompleks dhe rrjedhimisht sfidues. Projekti i ATK-së është ende në fazën e vlerësimit (afër finalizimit), kështu që fillimi i implementimit pritet të bëhet pas nënshkrimit të kontratës.

Me qëllim të marrjes së masave preventive, pas vlerësimit të ofertave të Operatorëve Ekonomik si dhe demonstrimeve të disa prej funksioneve të produkteve/zgjidhjeve të ofruara, Komisioni Vlerësues dhe Zyra e Prokurimit, do të dalin me një raport të vlerësimit më së largu deri në Nëntor 2019.

¹ ANEKS 1. SHPJEGIM I DETAJUAR MBI ZBATIMIN E SECILIT AKTIVITET

Aktiviteti 5.2.- Në pjesën e parë të vitit nuk ka pas zhvillime lidhur me hartimin e Dokumentit analitik për menaxhimin e performancës. Me qëllim të zbatimit të këtij aktiviteti, pritet të formohet sa më parë grupi punues për hartimin e Dokumentit analitik për menaxhimin e performancës. Vonesa në formimin e grupit Punues mund të sfidoj zbatimin e tij.

Aktiviteti 7.6.- Raporti gjen se gjatë periudhës raportuese, nuk ka pasur trajnime në fushën e prokurimit publik. Edhe pse trajnimet e nivelit të avancuar si dhe atij bazik janë planifikuar të zhvillohen në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019, sigurimi i mjeteve të nevojshme si dhe kapaciteteve mund të jetë sfidë.

Programi i trajnimit të avancuar i 424 zyrtarëve të prokurimit që kanë certifikatë themelore në fushën e prokurimit publik do të fillojë në Shtator të 2019. Si rezultat, 424 zyrtarët e prokurimit që kanë certifikatë themelore në prokurimin publik dhe e cila ka vlefshmëri deri në fundin e vitit 2019, është domosdoshmëri që të pajisen me certifikatë të avancuar. KRPP, sipas kërkesave të paraqitura nga zyrtaret e prokurimit dhe personat e tjerë të interesuar, do të mbajë trajnim themelor profesional për prokurim publik për vitin 2019. Numri i zyrtarëve të prokurimit dhe personave të tjerë të interesuar të cilët pritet të pajisen me certifikatë themelore është 30-40.

Aktiviteti 11.2.- Gjatë vitit 2019 është planifikuar që diagrami i llogarive gjegjësisht plani kontabël të rishikohet sipas kërkesave të reja të IPSAS në pjesën e dytë të vitit. Klasifikimi i saktë dhe respektimi i planit kontabël është edhe rekomandim i auditimit, andaj gjatë vitit 2019 do të jetë në fokus edhe i buxhetimit. Pas rishikimit do të filloj ngritja e kapaciteteve.

Sfiduese do të jetë aspekti kohor, harmonizimi i aktiviteteve dhe resurseve në mënyrë që planifikimi i buxhetit 2020 të reflektoj kërkesën për klasifikim dhe zbatim të saktë të rregullores për planin kontabël.

Aktiviteti 12.1.- Përkundër zhvillimeve pozitive si sigurimi i mjeteve për zhvillimin e Studimit të fizibilitetit nga Buxheti i Kosovës dhe fillimit të zhvillimit të dokumentacionit relevant për tenderim, sfiduese do të jetë fillimi i implementimit të projektit. Për shkak të mungesës së kapaciteteve nuk është zhvilluar dokumentacioni tenderues. Sfiduese është edhe vet procesi i tenderimit në aspektin e kohës së nevojshme deri në finalizimin e përzgjedhjes së kompanisë fituese. Si masë korrigjuese/preventive është duke u komunikuar me LuxDev mundësia që të angazhohet një ekspert për hartimin e dosjes së tenderimit.

1. RAPORTI I PËRGJITHSHËM SIPAS SHTYLLAVE

1.1 SHTYLLA 1: DISIPLINA FISKALE

PRIORITETI 1: SAKTËSIA E PARASHIKIMIT TË INDIKATORËVE MAKROEKONOMIK DHE TË HYRAVE:

Prioriteti i parë i SRMFP edhe pas rishikimit, i referohet avancimit të saktësisë së parashikimit të indikatorëve makroekonomik, përfshirë parashikimet ekonomike, ngritjen e kapaciteteve dhe avancimin e modelit Makro-Ekonomik. Po ashtu ka për qëllim rritjen e transparencës përmes publikimit të metodologjisë së parashikimeve ekonomike. Arritja e këtij prioriteti përmirëson cilësinë e informatave të nevojshme për vendim-marrësit politik si dhe do të krijojë një bazë të shëndoshë për bashkëpunim efektiv me partnerët financiar ndërkombëtar e në veçanti me BE-në duke adresuar rekomandimet e Komisionit Evropian nga Takimi i Dialogut Ekonomik dhe Financiar ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, 2018. Kjo do të kontribuoj ruajtjes së stabilitetit makroekonomik si një prej synimeve afatgjatë të menaxhimit të financave publike.

Për gjashtëmujorin e parë të vitit 2019, mund të raportojmë se kapacitetet e njësisë së makroekonomisë janë duke u ngritur. Me ndihmën e projektit mbështetës të BE-së është duke u avancuar modeli Makro-Ekonomik, i cili do të përmirësoj edhe më tej parashikimin e indikatorëve kryesor makroekonomik. Është adresuar edhe rekomandimi i KE-së lidhur me opsionet e mundshme për krijimin e një trupi të pavarur për mbikëqyrjen fiskale, duke themeluar një grup pune që do të analizojë dhe propozoj Qeverisë opsionin më të mirë.

Në kuadër të këtij prioriteti, janë planifikuar katër (4) aktivitete. Megjithatë ajo çfarë mund të thuhet është se gjatë këtij gjashtëmujorit (Janar - Qershor 2019), nga katër aktivitetet e planifikuara për arritjen e këtij prioriteti, tri aktivitete janë duke u zbatuar sipas planit ndërsa një aktivitet (1.2) nuk ka pas zhvillime por pritet të zbatohet më vonë.

Tek Indikatori i parë mund të raportojmë se është ruajtur trendi i parashikimit të kujdesshëm dhe real i të hyrave tatimore. Sipas raportit preliminar për periudhën Janar-Qershor 2019, shmangia mesatare e të hyrave të realizuara në krahasim me parashikimin e të hyrave tatimore është -2.4%, që siguron trendin pozitiv drejt vlerës së synuar për vitin 2019 (-6% deri 12%) si dhe cakun në 2020.



OBJEKTIVI . - Një parashikimi i kujdesshëm dhe real i të hyrave tatimore.

| 1.- Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit | Baza | Pika e referimit 2019 | Qëllimi 2020 | Raportimi Janar-Qershor 2019 |
|--|---------|-----------------------|--------------|------------------------------|
| Shmangia parashikimit të të hyrave tatimore në krahasim me të hyrat e realizuara (Indikatori nga SBS). | (-1.1%) | -6% deri 12% | -5% deri 10% | -2.4% |

PRIORITETI 2: KONTROLLET EFEKTIVE TË ZOTIMEVE

Aftësia për të shlyer në kohë (1-30 ditë) pagesat e arritura është prioriteti 2 i reformës në shtyllën e parë. Qëllimi i këtij prioriteti janë kontrollet efektive të zotimeve, ku synohet të arrihet duke menaxhuar më mirë vonesat e pagesave përmes kontrolleve financiare në zotime. Institucionet kryesore përgjegjëse për arritje të këtij prioriteti janë Thesari dhe Njësia Qendrore Harmonizuese.


Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2019, është raportuar të jetë shënuar progres në zbatimin e të gjitha aktiviteteve (shtatë) që kanë pasur Pikë Referimi në vitin 2019 (2.1, 2.3, 2.4, 2.5, 2.6, dhe 2.7)². Për aktivitetin 2.8 janë ndërmarrë masat përgatitore dhe gjatë pjesës së dytë të vitit pritet që me Ligjin e Buxhetit të saktësohet baza ligjore për zotime tre vjeçare. Ndërkaq Aktiviteti 2.2 nuk ka Pikë Referimi për vitin 2019 ngase është proces që do zgjasë për një periudhë së paku 5 vjeçare. Andaj është aktivitet që Pikë Referuese ka vetëm për vitin 2020.

Brenda kësaj periudhe është draftuar Rregulla Financiare për Monitorim të Organizatave Buxhetore dhe gjatë vitit 2019 do të finalizohet. Ka filluar së implementuari arkiva elektronike me qëllim të avancimit të mëtejshëm gjatë vitit 2019. Me qëllim të zbatimit të Ligjit për Kontroll të Brendshëm të Financave Publike (KBFP), janë mbajtur trajnime me qëllim të njoftimit të zyrtarëve relevant me risitë dhe kërkesat e dala nga Ligji për KBFP. Gjithashtu, janë hartuar dhe aprovuar katër (4) akte nënligjore për zbatimin e ligjit për KBFP. Janë monitoruar dy (2) Subjekte të Sektorit Publik (SSP) dhe janë përfunduar raportet e monitorimit, ndërsa për dy SSP monitorimi ka filluar. Përshkrimi i proceseve dhe standardi unik i menaxhimit të rrezikut, i përkrahur nga USAID, ka filluar të zbatohet përmes pilot projekteve të nivelit lokal. Bazuar në analizën e pyetësorëve vet vlerësues si dhe raporteve të pranuar nga NJAB, është hartuar Raporti i konsoliduar

² Shpjegimet detaje për progresin në secilin aktivitet janë dhënë në Aneksin 1

vjetor për funksionimin e sistemit të KBFP-së (MFK+AB) për vitin 2018. Raporti vjetor është aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK) në Qershor 2019.

Aktualisht nuk ka mundësi për të dhënë shënime për indikatorin e këtij prioriteti, pasi që raportimi është i mundur vetëm pas raportit financiar në fund të vitit 2019. Me qëllim të arritjes së indikatorit, Thesari i Kosovës në harmoni me kompetencat dhe autorizimet e LMFPP-së ka ndërmarr masa dhe ka organizuar takime të përbashkëta me ZKF-të e OB-ve për të tërhequr vëmendjen dhe duke i informuar ata që hyrja dhe krijimi i obligimeve pa pasur buxhet është shkelje ligjore.

|  Objektivi.- Zvogëlimi i vonesave të pagesave duke e rritur pajtueshmërinë me kontrollet e aplikueshme të zotimeve. | | | | |
|---|-------------|------------------------------|---------------------|-------------------------------------|
| 2.- Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit | Baza | Pika e referimit 2019 | Qëllimi 2020 | Raportimi Janar-Qershor 2019 |
| Borxhet e pakryera të pagesave deri në fund të vitit fiskal si % e totalit të shpenzimeve (Indikatori nga SBS). | 4.3% | 3% | 2% | Raportimi në fund të vitit. |

PRIORITETI 3: MBLEDHJA E QËNDRUESHME E TË HYRAVE

Sistemi aktual i menaxhimit të financave publike në Kosovë vazhdon të mbështes disiplinën e përgjithshme fiskale. Për ta mbajtur qëndrueshmërinë në disiplinën fiskale është e nevojshme gjetja e zëvendësimeve të brendshme për të hyrat nga kufiri, e cila do të ndikojë në financimin e investimeve publike të nevojshme për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe për t'i adresuar sfidat e shumta.

Janë gjithsej shtatë (7) aktivitete të planifikuara për realizimin e Prioritetit 3, Mbledhja e Qëndrueshme e të Hyrave, me përgjegjësi të ndara në mes të ATK-së, Doganës së Kosovës dhe Departamentit të Tatimit në Pronë (DTP). Raporti konstaton se është arritur progres në zbatimin e të gjitha aktiviteteve të planifikuara³. Sfidues vlerësohet zbatimi i Aktivitetit 3.3.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2019, me aktivitete të vazhdueshme nga ATK është ngritur përmbushja e deklaramit me kohë. Kjo është rezultat i përdorimit të modulit për Menaxhimin e mos-deklaruesve në TVSH si dhe funksionalizimin e Njësisë për trajtimin

³ Shpjegimet detaje për progresin në secilin aktivitet janë dhënë në Aneksin 1

e mos deklaruesve dhe deklaruesve me vonesë. Përmes vlerësimit automatik të rreziqeve të tatimpaguesve me rrezik të ulët është arritur progres në përshpejtimin e rimbursimit të TVSH-së për shtatë (7) ditë. Kështu nga 30 ditë sa ishte në periudhën Janar-Qershor 2018, është ulur në 23 ditë në periudhën Janar-Qershor 2019.

Dogana e Kosovës (DK) me qëllim të luftimit të kontrabandimit të mallrave dhe lehtësimit të tregtisë ka finalizuar specifikat teknike të sistemit të kontrollimit me Barcode - RFID dhe është në proces të furnizimit me pajisje. Është arritur progres në ngritjen e kapaciteteve të DK për mbledhje të qëndrueshme të të hyrave përmes trajnimit të 117 zyrtarëve doganor.

Gjithashtu është evidentuar progres në ngritjen e kapaciteteve të Departamentit të Tatimit në Pronë (DTP) në implementimin e Ligjit të ri Nr. 06/L-005 të Tatimit në Pronën e Paluajtshme. Si rezultat i kapaciteteve të ngritura dhe zbatimit të ligjit, të hyrat nga tatimi në pronë gjatë periudhës Janar-Qershor 2019 kanë shënuar një rritje prej 1,264,691.00 Euro, apo 9% më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit 2018.


Përkundër aktiviteteve të ndërmarra lidhur me Modernizimin e sistemit të teknologjisë informative (Aktiviteti 3.3), duhet thënë se si proces mbetet sfidues. Projekti është në fazën e vlerësimit (afër finalizimit), kështu që fillimi i implementimit pritet të bëhet pas nënshkrimit të kontratës që pritet të ndodhë në pjesën e dytë të vitit 2019.

Për sa i përket dy indikatorëve të Prioritetit 3, të dhënat tregojnë se tek indikator i parë kemi një rritje të numrit të tatimpaguesve që i deklarojnë të ardhurat në mënyrë vullnetare në 63,327 (67,702 Pika e Referimit për vitin 2019). Me qëllim të ngritjes së numrit të tatimpaguesve deklarues, në mënyrë të rregullt është duke u zbatuar aktiviteti i pastrimit të regjistrit të tatimpaguesve, duke i larguar nga regjistri ata tatimpagues që nuk janë aktiv dhe duke i monitoruar mos-deklaruesit përmes veglës së menaxhimit të mos deklaruesve. Me qëllim të rritjes së përmbushjes tatimore nga ana e tatimpaguesve, ATK ka hyrë në periudhën e zbatimit të reformës "Përmirësimi i Përmbushjes Tatimore". Për fillim si sektor me rrezikun më të lartë për mos-përmbushje është identifikuar sektori i ndërtimtarisë. Lidhur me zbatimin e kësaj reforme pritet që gjatë muajve Korrik, Gusht, Shtator dhe Tetor të realizohen aktivitetet edukuese por edhe masa të kontrollit tatimor. Aktualisht ATK është duke zbatuar disa reforma në përmirësimin e performancës institucionale sipas planit të ATK "Plani afatmesëm i reformës 2019 -2021" dhe këto reforma mund të kenë ndikim në arritjen e Indikatorit.

Gjithashtu tek indikator i dytë kemi ulje të nivelit të borxhit tatimor si përqindje e të hyrave totale vjetore (Indikator nga SBS) në 29.5% (29% Pika e Referimit për vitin 2019). ATK do të vazhdohet me masat që do të ruajnë këtë nivel. Po ashtu, ATK është në proces të konsolidimit të funksionit të mbledhjes së borxheve, duke e bërë si funksion të centralizuar nëpër disa qendra. Fillimisht është filluar me regjionin e Prishtinës pastaj do të vazhdohet me regjione tjera. Gjithashtu me strukturën e re organizative është paraparë që të centralizohet edhe funksioni i konfiskimeve. Si një nga veprimet operacionale është

edhe rritja e aktiviteteve në terren të zbatimit të procedurave për pagesën e tatimeve, e deri tek zbatimi i masave të mbledhjes së detyrueshme.

Zbatimi i reformës së centralizimit të funksionit të mbledhjes së borxheve mund të ketë ndikim në zbatimin e Indikatorit, pasi që është një reformë që zgjat tri vite, kërkon resurse të dedikuara si dhe mund të ketë rezistencë të stafit ndaj ndryshimeve.

|  Objektivi.- Zgjerimi i bazës tatimore përmes luftimit të evazionit fiskal dhe kontrabandimit të mallrave. | | | | |
|--|-------------|------------------------------|---------------------|-------------------------------------|
| 3.- Indikator (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit | Baza | Pika e referimit 2019 | Qëllimi 2020 | Raportimi Janar-Qershor 2019 |
| Numri i tatimpaguesve që i deklarojnë të ardhurat në mënyrë vullnetare. | 62,886 | 67,702 | 100,000 | 63,327 |
| Ulja e nivelit të borxhit tatimor si përqindje e të hyrave totale vjetore (Indikator nga SBS). | 35% | 29% | 25% | 29.5% |

1.2 SHTYLLA 2: EFIKASITETI ALOKUES

PRIORITETI 4: ZHVILLIMI I KORNIZËS AFATMESME TË SHPENZIMEVE (KASH)

Viteve të fundit kemi pasur një përmirësim të vazhdueshëm të ndërlidhjes në mes të strategjive kombëtare dhe planifikimit buxhetor afatmesëm dhe vjetor. Me rishikim të Planit të veprimit për vitet 2019-2020 janë paraparë tri (3) Aktivitete me qëllim të zhvillimit të KASH.


Qasja sektoriale, komunikimi dhe këshillimi i profesionalizuar nga MF tek OB-të, ka ndikuar në fuqizimin e integritetit të KASH-it si dokument bazë për përpilimin e buxhetit vjetor dhe vlerësimin për dy vitet e ardhshme.

Ministria e Financave ka vazhduar me ngritjen e kapaciteteve të OB përmes trajnimeve /këshillimeve kryesisht në Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor (VNB) të nismave të reja qeveritare. Përmes Instruksionit të lëshuar nga MF për përgatitjen e KASH, është siguruar që KASH të hartohet duke u bazuar në Deklaratën e Prioriteteve të Qeverisë, pra të ju jepet përparësi prioriteteve nga deklarata. Për më shumë, në opinionet e

vlerësimit të ndikimit buxhetor kërkohet si shtesë edhe deklarimi lidhur me korrektësinë e paraqitjes së të dhënave nga ana e OB në formular të VNB.

Janë gjithsej tri (3) aktivitete të planifikuara në planin e veprimit të SRMFP-së, me qëllim të avancimit të mëtejme të rolit të KASH-it si dokument ndërlidhës ndërmjet Strategjisë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) dhe planifikimit të buxhetit për tre vitet ardhshme. Në krahasim me Pikat Referuese për vitin 2019, është evidentuar progres në zbatimin e të tri aktiviteteve 4.1; 4.2; dhe 4.3.

Aktualisht, shmangia në mes të kufirit të dhënë me KASH- 2019 dhe buxhetit të aprovuar për vitin 2019 është 8.97% (pika e referimit për 2019 është 6.50%). Pritjet janë se deri në fund të vitit do të arrihet Pika e Referimit për vitin 2019.

|  | Objektivi.- Avancimi i mëtejme i rolit të KASH si dokument ndërlidhës ndërmjet Strategjive Kombëtare dhe planifikimit të buxhetit për tre vitet e ardhshme. | | | |
|--|--|------------------------------|---------------------|-------------------------------------|
| 4.- Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit | Baza | Pika e referimit 2019 | Qëllimi 2020 | Raportimi Janar-Qershor 2019 |
| Përqindja e shmangies mesatare ndërmjet kufirit të KASH dhe kufirit vjetor buxhetor për OB-të. | 7.15 % | 6.5 % | 5% | 8.97% |


PRIORITETI 5: BESUESHMËRIA DHE KONTROLLI I EKZEKUTIMIT TË BUXHETIT VJETOR

Fuqizimi i besueshmërisë së buxhetit vjetor përmes përmirësimit të planifikimit buxhetor përfshirë planifikimin në nivel të programeve dhe përputhjes me kornizën makro-fiskale si dhe Prioritetet strategjike të Qeverisë është një ndër prioritetet e SRMFP-së. Në kuadër të këtij prioriteti janë planifikuar dy (2) aktivitete. Në lidhje me udhëzimin administrativ (UA) për transferimet/ri-alokimet, është hartuar UA dhe pritet të aprovohet së shpejti dhe me ndihmën e GIZ të filloj trajnimi i zyrtarëve në OB për zbatimin e këtij UA. Ndërsa pritet që në pjesën e dytë të vitit të formohet Grupi punues për hartimin e Dokumentit analitik për menaxhimin e performancës.

Sa i përket përqindjes së shmangies mesatare të ekzekutimit të përgjithshëm të buxhetit qendror krahasuar me buxhetin e aprovuar në fillim të vitit sipas OB-ve të nivelit qendror, në këtë periudhë të raportimit nuk mund të llogaritet, pasi që për matjen e këtij

Indikatori duhet të merret për bazë buxheti i aprovuar në fillim të vitit dhe buxheti i realizuar në fund të vitit.

Për Indikatorin e dytë kemi një gjendje shumë të mirë pasi që në periudhën Janar – Qershor 2019 janë bërë gjithsej 26 transfere (Pika e Referimit për 2019 është 140 transfere).

|  Objektivi.- Fuqizimi i besueshmërisë së buxhetit vjetor përmes përmirësimit të planifikimit buxhetor dhe besueshmërisë së tij, përfshirë planifikimin në nivel të programeve, për të siguruar që hartimi i buxhetit është në përputhje me kornizën makro-fiskale si dhe objektivat strategjike të Qeverisë. | | | | |
|--|-------------|------------------------------|---------------------|-------------------------------------|
| 5.- Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit | Baza | Pika e referimit 2019 | Qëllimi 2020 | Raportimi Janar-Qershor 2019 |
| Përqindja e shmangies mesatare të ekzekutimit të përgjithshëm të buxhetit krahasuar me buxhetin e aprovuar në fillim të vitit sipas OB të nivelit qendror. | -14.9% | -7.5% deri +7.5% | 5% | Raportimi në fund të vitit. |
| Nr. i transfereve gjatë vitit fiskal | 178 | 140 | 120 | 26 |

PRIORITETI 6: CILËSIA E INFORMATAVE TË BUXHETIT KAPITAL

Ndërlidhja sistematike e projekteve kapitale me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim (SKZH) dhe me politikat sektoriale, cilësinë e analizës teknike të projekteve është një nga Prioritetet e SRMFP. Gjatë periudhës raportuese është vazhduar me rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit të menaxhimit të planifikimit dhe monitorimit të investimeve publike nga OB-të në sistemin e PIP (Programi i Investimeve Publike).

Udhëzimi Administrativ (UA) për kriteret përzgjedhëse dhe prioritizimin e projekteve kapitale si dhe UA për definimin e projekteve kapitale janë hartuar nga GP-të dhe pritet aprovimi i tyre. Pas aprovimit do të vijon trajnimi i zyrtarëve të OB për këto UA në K4 2019. Prandaj për progresin e tërësishëm do të raportohet në raportin vjetor. Po ashtu janë organizuar trajnime për sistemin PIP me qëllim të trajnimit të zyrtarëve të rinj si dhe rifreskimit të njohurive të zyrtarëve ekzistues.

Për arritjen e këtij prioriteti janë planifikuar gjithsej tri (3) aktivitete. Në krahasim me Pikat Referuese për vitin 2019, është evidentuar progres në të tri aktivitetet.

Për sa i përket indikatorit të parë, në këtë periudhë gjashtëmuajore të raportimit Janar-Qershor 2019 janë bërë gjithsej vetëm 10 rialokime (pika e referimit për 2019 është 45

rialokime). Ndërsa për indikatorin e dytë, raportohet se në vitin 2019 përqindja e pjesëmarrjes së shpenzimeve kapitale në strukturën e buxhetit është 33.1 % (Pika e Referimit për 2019 është 33%).

| Objektivi.- Një menaxhim më efikas dhe më efektiv i planifikimit dhe monitorimit të investimeve publike nga OB-të në sistemin e PIP-it do të ndikoj në një planifikim të drejt të projekteve kapitale që duhet të jenë të ndërlidhura me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe me prioritetet e Qeverisë | | | | |
|---|------|-----------------------|---------------|------------------------------|
| 6.- Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit | Baza | Pika e referimit 2019 | Qëllim i 2020 | Raportimi Janar-Qershor 2019 |
| Numri i ri-alokimeve për OB të nivelit qendror. | 55 | 45 | 30 | 10 |
| Ruajtja e nivelit të shpenzimeve kapitale të planifikuara në raport me strukturën e shpenzimeve të përgjithshme. | 33% | 33% | 33.5 % | 33.1% |

1.3 SHTYLLA 3: EFIKASITETI OPERACIONAL


PRIORITETI 7: PROKURIMI PUBLIK

Në këtë Prioritet të reformës së SRMFP, është vazhduar të ndërmerren veprimet e nevojshme me qëllim të ngritjes së përdorimit efikas dhe transparent të fondeve publike. UA për prokurimet e centralizuara për vitin 2019 është aprovuar në Qershor 2019. Në Agjencionin Qendror të Prokurimit (AQP) janë punësuar tre zyrtar të rinj, ndërsa pjesa tjetër prej tre zyrtarëve të planifikuar do të përzgjidhen deri në fund të vitit. Plotësim-ndryshimi i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP) ka hyrë në fuqi më 16.04.2019. Sistemi i e-prokurimit, në kryerjen e aktiviteteve të prokurimit, nga 1 Janari 2019, është bërë obligative dorëzimi i ofertave në formë elektronike nga operatorët ekonomik gjatë pjesëmarrjes në aktivitetet e prokurimit me vlera të mëdha. Nga 1 Janari 2019, për të gjitha procedurat e prokurimit, dorëzimi i ofertave nga operatorët ekonomik pjesëmarrës në aktivitetet e prokurimit bëhet vetëm në formë elektronike. Nuk ka dorëzim fizik të ofertave. Në vazhdimësi bëhet monitorimi i aktiviteteve të prokurimit, të ngritura dhe të publikuara në platformën e e-prokurimit. Është themeluar Grupi punues për hartimin e Koncept Dokumentit (KD) për trajtimin e legjislacionit në fushën e Prokurimit Publik. Është punuar në draft koncept dokument duke zhvilluar edhe diskutim publik. KD do të përkthehet në gjuhët zyrtare dhe do të dërgohet për konsultime ndër-institucionale dhe publike dhe pritet të finalizohet dhe

aprovohet në periudhën K3-K4, 2019. Për sa i përket trajnimit të zyrtarëve të prokurimit publik në nivel bazik dhe të avancuar, nuk ka pas aktivitete, por janë planifikuar të zhvillohen në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019, raportohet se për gjashtë (6) aktivitetet e planifikuara, në krahasim me pikat referuese për vitin 2019 është evidentuar progres në zbatimin e pesë aktiviteteve, ndërsa një aktivitet (7.6) pritet të zbatohet sipas planit deri në fund të vitit.

Raportimi në bazë të indikatorëve do të jetë i mundur në fund të vitit.

|  | Objektivi.- Sigurimi i përdorimit efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike si dhe realizimi i parimit kryesor në prokurimin publik “vlera për para”. | | | |
|--|---|---------------------------------------|--|-------------------------------------|
| 7.- Indikatorit (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit | Baza | Pika e referimit 2019 | Qëllimi 2020 | Raportimi Janar-Qershor 2019 |
| Përqindja e përdorimit të Procedurës së Negociuar pa publikim. | 12,98% | 9% | 7% | Raportimi në fund të vitit |
| Përqindja vjetore e vlerës së kontraktuar të mallrave dhe shërbimeve nga AQP në krahasim me vlerën e kontraktuar vjetore të mallrave dhe shërbimeve në PP (Indikatorit nga SBS). | Më e lartë apo e barabartë me (≥) 14% | Më e lartë apo e barabartë me (≥) 14% | Më e lartë apo e barabar të me (≥) 18% | Raportimi në fund të vitit |

PRIORITETI 8: FUQIZIMI I AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Fuqizimi i auditimit të brendshëm është me rëndësi sepse ndihmon menaxhmentin në arritjen e objektivave të organizatës duke dhënë këshilla të pavarura për fuqizimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të financave publike, vlerësuar lidhjet e këtyre sistemeve në arritjen e objektivave, bërë vlerësimin e rreziqeve që shoqërohen me sistemet në arritjen e qëllimeve të qeverisë dhe ndihmon në ngritjen e standardeve të qeverisjes.

Ka filluar zbatimin e metodologjisë për monitorimin e NjAB, të harmonizuar me kërkesat e reja të Ligjit dhe akteve nënligjore për KBFP. Deri në Qershor 2019 janë monitoruar tetë (8) NjAB dhe një është në proces të monitorimit. Me qëllim të ngritjes së kapaciteteve është organizuar konferenca për "Fuqizimin e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike - llogaridhënia menaxheriale" me 174 pjesëmarrës. Programin për certifikim të auditorëve të brendshëm e kanë përfunduar me sukses 32 kandidatë. Në bashkëpunim


me IKAP janë trajnuar 160 anëtarë të komitetit të auditimit, ndërsa me përkrahjen e USAID janë mbajtur dy punëtori në nivel komunal me 50 pjesëmarrës.

Në këtë kontekst me qëllim të arritjes së prioritetit për Fuqizim të funksionit të auditimit të brendshëm, me rishikim janë planifikuar gjithsej tri (3) aktivitete që ndërlidhen me fuqizimin e auditimit të brendshëm si parakusht për shtimin e vlerës ndaj menaxhimit llogaridhënës. Në krahasim me pikat referuese për vitin 2019, është evidentuar progres në zbatimin e të tri aktiviteteve. Në dy aktivitete tashmë kanë arritur pikat e referimit.

Lidhur me përqindjen (%) e auditorëve të brendshëm të certifikuar, raportohet se mbi 93% të AB janë certifikuar (80% pika e referimit për 2019).

Për vitin 2018 janë implementuar 51.32% e rekomandimeve të auditimit të brendshëm nga menaxhmenti, 30.36 janë në proces dhe 17.82 nuk janë implementuar. Ndërsa sa i përket përqindjes (%) së Implementimit të rekomandimeve nga menaxhmenti për vitin 2019 do të paraqitet në Raportin e konsoliduar vjetor për funksionimin e sistemit të KBFP në vitin 2020.

Hapat në Vijim: Nga të SSP është kërkuar që të përgatitin planet e veprimit për implementimin e rekomandimeve në mënyre sistematike.

|  Objektivi.- Fuqizimi i funksionit të auditimit të brendshëm si shërbim me vlerë të shtuar ndaj menaxhimit llogaridhënës | | | | |
|---|-------------|------------------------------|---------------------|-------------------------------------|
| 8.- Indikator (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit | Baza | Pika e referimit 2019 | Qëllimi 2020 | Raportimi Janar-Qershor 2019 |
| Përqindja (%) e auditorëve të brendshëm të certifikuar. | 50% | 80% | 90% | 93% |
| Përqindja (%) e implementimit të rekomandimeve nga menaxhmenti | 51% | 55% | 65% | Raportimi në fund të vitit |

PRIORITETI 9: FUQIZIMI I AUDITIMIT TË JASHTËM


Prioriteti nëntë (9) i shtyllës së tretë merret me auditimin e jashtëm dhe rezultati kryesor është zhvillimi i një institucioni suprem të auditimit që funksionon mirë, i cili kryen auditime në përputhje me standardet e auditimit të sektorit publik, të pranuar ndërkombëtarisht.

Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore është raportuar progres në zbatimin e të gjitha aktiviteteve. Për më shumë aktiviteti 9.3 është përfunduar.

Me qëllim të ruajtjes së pavarësisë institucionale, ZKA ka themeluar grupin punues i cili ka identifikuar çështjet me rëndësi për adresim dhe ka nxjerrë një koncept dokument me sqarimet e nevojshme. Ky dokument është qarkulluar tek grupi menaxhues i ZKA-së për komente dhe ditëve në vijim do të diskutohet më gjerësisht. Kanë përfunduar përgatitjet për avancimin e metodologjisë së auditimit, përmes automatizimit të sistemit. Aktualisht softueri i auditimit është në proces të tenderimit. Doracak i auditimeve të rregullsisë i përditësuar si dhe Udhëzuesi për menaxhimin e cilësisë janë në pajtim me SNISA dhe duke u zbatuar. Pako e letrave të punës të auditimeve të performancës është përditësuar, ndërsa përditësimi i manualit të auditimit të performancës është në proces. Për periudhën janar- qershor 2019 janë publikuar 4 auditime të performancës. Bashkëpunimi me Kuvendin e Kosovës është konkretizuar me dy konferenca rajonale. Si rezultat i takimit me kërkesë të Komisioneve Parlamentare (Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike - KMFP dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa - KBF) dhe përkrahjes nga GIZ, deri në Qershor 2019 janë mbajtur gjithsejtë 8 mbledhje ku janë shqyrtuar 5 raporte të auditimit. Raporti gjashtëmujor i planit të zbatimit të rekomandimeve të ZKA për vitin 2017 është hartuar. Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin nr. 08/69, datë 16.10.2018, ka aprovuar planin e veprimit për zbatim të rekomandimeve të Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2017 (RVA 2017).

Gjendja aktuale e zbatimit të indikatorit të parë për periudhën janar- qershor është se janë mbajtur gjithsejtë 8 mbledhje ku janë shqyrtuar 5 raporte të auditimit. Për rezultatin e plotë të këtij indikator do të raportohet periudhën e ardhshme, përkatësisht në fund të vitit.

Për sa i përket Indikatorit të dytë dhe të tretë, përqindja rekomandimeve të adresuara dhe të pa adresuara të lëshuara nga ZKA, sipas Raporteve individuale të Auditimit të publikuara për vitin 2018, është paraqitur progresi në zbatimin e rekomandimeve të dala nga raporti i auditimit për vitin 2017. Pas përpunimit të dhënave, rezultatet do të prezantohen në Raportin Vjetor të Auditimit për vitin 2018, i cili publikohet në muajin gusht 2019.

|  | Objektivi.- Zhvillimi i një institucioni suprem të auditimit që funksionon mirë, i cili kryen auditime në përputhje me standardet e auditimit të sektorit publik të pranuar ndërkombëtarisht. | | | |
|---|--|------------------------------|----------------------|--|
| 9.- Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit | Baza | Pika e referimit 2019 | Qëllim i 2020 | Raportimi Janar-Qershor 2019 |
| Përqindja e raporteve të auditimit të shqyrtuara nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike. | 10% | 20% | 20% | 8 mbledhje ku janë shqyrtuar 5 raporte të auditimit. |
| Përqindja e rekomandimeve të adresuara të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit. | 32 % | 34% | 35% | Publikohet në muajin gusht 2019 |
| Përqindja e rekomandimeve të pa adresuara të lëshuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit. | 37% | 30% | 30% | Publikohet në muajin gusht 2019 |

1.4 SHTYLLA 4: ÇËSHTJET E NDËRLIDHURA TË MFP

PRIORITETI 10: PËRMIRËSIMI I SISTEMEVE TË TI

Prioriteti dhjetë (10) ka për qëllim përmirësimin e sistemeve të teknologjisë informative me qëllim të përmirësimit të menaxhimit të financave publike. Për arritjen e këtij prioriteti, janë gjithsej dy (2) aktivitete të planifikuara. Në krahasim me Pikat Referuese për vitin 2019 është evidentuar progres në zbatimin e të gjithave aktiviteteve.

Integrimi i sistemeve në MF dhe Agjencitë e saj vartëse ka përfunduar dhe është funksional, ndërsa zhvillimi i DWH (Data warehouse) dhe sistemit raportues (BI-Business Intelligence) është në vijim e sipër. Janë siguruar pajisjet harduerike për krijimin e qendrës së të dhënave financiare (Disaster Recovery System), ku gjatë tremujorit të tretë pritet simulimi i qendrës për të vazhduar tutje me sinkronizim me kapacitete të plota.

Për sa i përket Indikatorit për matjen e arritjes së Prioritetit, aktualisht janë integruar shtatë (7) sisteme të parapara si Pikë Referimi për vitin 2019.



Objektivi.- Përmirësimi i sistemeve të TI që funksionojnë në Ministrinë e Financave për ta përmirësuar cilësinë e informatave financiare.

| 10.- Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit | Baza | Pika e referimit 2019 | Qëllimi 2020 | Raportimi Janar-Qershor 2019 |
|--|------|-----------------------|--------------|------------------------------|
| Numri i sistemeve të Integruara. | 0 | 7 | 7 | 7 |

PRIORITETI 11: TRANSPARENCA PËR BUXHETIN

Prioriteti i njëmbëdhjetë (11) ka të bëjë me sigurimin e transparencës së shpenzimit të fondeve publike, që për prioritet ka sigurimin e pajtueshmërisë së informatave për Buxhetin e Kosovës me FMN, përkatësisht me standardin 2014 GFS. Janë gjithsej katër (4) aktivitete të planifikuara për përmbushje të këtij prioriteti. Bartës kryesor i këtyre aktiviteteve është Thesari dhe Dep. i Buxhetit, MF. Gjatë periudhës raportuese Janar-Qershor 2019, është raportuar për progres të kënaqshëm në zbatimin e 3 aktiviteteve, ndërsa për aktivitetin 11.2 planifikimi është të realizohet në pjesën e dytë të vitit.

Gjatë periudhës raportuese janë krijuar formula specifike për gjenerimin e raporteve kristale në SIMFK sipas kërkesave nga fusha e raportimeve, të cilat shërbejnë për raportim sipas IPSAS dhe GFSM 2014.

Për sa i përket planit kontabël, pritet që në pjesën e dytë të vitit të rishikohet sipas kërkesave të reja të IPSAS dhe pas kësaj të fillohet me trajnimin e Zyrtarëve Kryesor Financiarë të OB-ve.

MF ka vazhduar me hartimin e Dokumentit të Buxhetit Miqësor (Narrativ) për vitin 2019 në të tri gjuhët i cili është publikuar në ueb faqen e MF-së në Prill 2019;

1. (Shq: <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,132>)
2. (Eng: <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=2,132>)
3. (Serb: <https://mf.rks-gov.net/page.aspx?id=3,132>)

Gjatë vitit 2019 është përgatitur Raporti vjetor financiar për vitin 2018, Raporti tremujor dhe gjashtëmujor i buxhetit 2019. Raportimi është duke u bërë në vazhdimësi në Portalin e Transparencës (<https://ptmf.rks-gov.net/page.aspx?id=1,1>).



Objektivi.- Sigurimi i pajtueshmërisë së informatave për buxhetin e Kosovës me FMN / standardin 2014 GFSM

| 11.- Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit | Baza | Pika e referimit 2019 | Qëllimi 2020 | Raportimi Janar-Qershor 2019 |
|---|--------------|--------------------------------------|----------------------------------|------------------------------|
| Buxhetimi dhe raportimi sipas tabelës së llogaritjeve që është në pajtim me GFSM 2014 | Nuk ekziston | Planifikimi Buxhetor sipas GFSM 2014 | Standard i GFSM 2014 në përdorim | Raportimi në fund të vitit |

PRIORITETI 12: NGRITJA E QËNDRUESHME E KAPACITETEVE NË MFP

Qëllimi i këtij prioriteti është ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve të shërbyesve civil në fushën e MFP. Është paraparë vetëm një aktivitet për arritjen e këtij Prioriteti.

Gjatë periudhës kohore Janar-Qershor 2019 janë ndërmarr disa iniciativa, të cilat nuk kanë rezultuar me zbatimin e studimit të Fizibilitetit. Vlen të theksohet se mjetet janë siguruar nga Buxheti i Kosovës. Në pjesën e dytë të vitit pritet që të kompletohet dokumentacioni tenderues dhe të tenderohet kërkesa për studim të fizibilitetit. Vlerësimi i nevojave për trajnim në fushën e MFP-së parashihet të realizohet si pjesë e studimit të fizibilitetit.



Objektivi.- Arritja e një mënyrë sistematike, e qëndrueshme dhe e integruar e ngritjes së kapaciteteve të nëpunësve civilë në Menaxhimin e Financave Publike duke e shfrytëzuar ekspertizën vendore, të administratës publike dhe atë të jashtme.

| 12.- Indikatori (-ët) për matjen e arritjes së Prioritetit | Baza | Pika e referimit 2019 | Qëllimi 2020 | Raportimi Janar-Qershor 2019 |
|--|------|--|--|------------------------------|
| 1. Zhvillimi i studimit të fizibilitetit mbi Qendrën e Trajnimeve për MFP, përfshirë vlerësimin e nevojave për trajnime. | NA | Zhvillimi i Studimit të fizibilitetit, e përfunduar. Vlerësimi i nevojave për trajnim në fushën e MFP-së, e përfunduar. | Adresimi i rekomandimeve që dalin nga përfundimi i studimit të fizibilitetit | Raportimi në fund të vitit |

ANEKS 1. SHPJEGIM I DETAJUAR MBI ZBATIMIN E SECILIT AKTIVITET

SHTYLLA 1 DISIPLINA FISKALE

Prioriteti 1: Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave;

Komente për statusin e aktiviteteve 1.1- 1.4

Në arritjen e prioritetit 'Saktësia e parashikimit të indikatorëve makroekonomik dhe të hyrave', janë paraparë 4 aktivitete që ndërlidhen më përforcimin e disiplinës fiskale si një parakusht, në mirëmbajtjen e qëndrueshmërisë fiskale. Aktivitetet përfshijnë ngritjen e kapaciteteve në njësinë e makroekonomisë, publikimin e metodologjisë së hartimit të parashikimeve ekonomike dhe avancimi i modelit Makro-Ekonomik, si dhe adresimin e rekomandimit të Komisionit Evropian nga Takimi i Dialogut Ekonomik dhe Financiar përmes hartimit të koncept dokumentit për themelimin e një Organi të Pavarur të Mbikëqyrjes Fiskale.

Gjatë periudhës raportuese Janar- Qershor 2019, nga katër (4) aktivitete të planifikuara për arritjen e këtij prioriteti, në tre (3) prej tyre (1.1, 1.3 dhe 1.4) është raportuar për progres gjatë kësaj periudhe, ndërsa lidhur me aktivitetin (1.2) që ndërlidhet me Publikimin e metodologjisë së hartimit të parashikimeve ekonomike nuk është shënuar progres, por pritet të zbatohet në pjesën e dytë vitit.

(1.1) Sigurimi i kapaciteteve të mjaftueshme të njësisë së makroekonomisë. Është mbajtur trajnim nga Banka Botërore për stafin në veçanti modelimin e indikatorëve makroekonomik dhe projeksionin e të hyrave. Nga data 13-17 Maj është mbajtur trajnimi nga Banka Botërore (BB) për Makro Modelim. Në trajnim kanë marrë pjesë 5 zyrtarë nga Njësia e Makroekonomisë. Nga data 20 Maj 2019 është mbajtur trajnimi lidhur me temën: Korniza e Riskut Kreditor, organizuar nga Banka Botërore ku kanë marrë pjesë 5 zyrtarë nga Makro dhe 3 zyrtarë nga Thesari (departamenti i borxhit). Gjatë pjesës së dytë të vitit pritet të mbahen trajnime nga ekspertët e projektit "Mbështetja për Zyrën e Planifikimit Strategjik" të financuar nga Komisioni Evropian.

(1.2) Publikimi i metodologjisë së hartimit të parashikimeve ekonomike. Nuk është ndërmarrë asnjë veprim për zbatimin e këtij aktiviteti. Është aktivitet që do të zhvillohet më vonë. Metodologjia e hartimit të parashikimeve ekonomike pritet të publikohet pas miratimit të Buxhetit për vitin 2020.

(1.3) Avancimi i modelit Makro-Ekonomik me qëllim të përmirësimit të parashikimit të indikatorëve kryesorë makroekonomik përfshirë edhe të hyrat tatimore. Me ndihmën e KE2 (key expert 2), nga projekti Mbështetja për Zyrën e Planifikimit Strategjik, ka filluar puna në hartimin e nën-modelit për analizimin dhe matjen e ndikimit social-ekonomik të politikave të PRE-së, deri më tani është përpiluar një kornizë bazë e të dhënave. Gjatë pjesës së dytë të vitit 2019, do të finalizohen nën-modelet.

(1.4) Adresimi i rekomandimit të Komisionit Evropian nga Takimi i Dialogut Ekonomik dhe Financiar ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, 2018, (Shqyrtimi i opsioneve KEF). Ministria e Financave ka themeluar një grup pune më 13.09.2018 në mënyrë që të analizojë opsionet e mundshme për krijimin e një trupi të pavarur për mbikëqyrjen fiskale, në përbërje të zyrtarëve shtetërorë dhe shoqërisë civile. Grupi i punës ka mbajtur disa takime dhe është duke analizuar modele për këtë trup. Në pjesën e dytë të vitit 2019 do të hartohet dokumenti analitik me opsione për themelimin e organit të pavarur për mbikëqyrje fiskale.

Prioriteti 2: Kontrollat efektive të zotimeve

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 2.1-2.8

Për arritjen e këtij qëllimi, strategjia pas rishikimit ka grupuar tetë (8) aktivitete. Marrë parasysh kohën për të cilën po raportohet, në krahasim me Pikat Referuese për vitin 2019, kemi vetëm një aktivitet (2.2) që nuk ka Pikë Referuese për vitin 2019, pra është aktivitet për vitin e ardhshëm. Për shtatë (7) aktivitetet tjera është evidentuar progres në zbatim apo edhe përfundim.

(2.1) Plotësim ndryshimet legjislative dhe zbatimi i rregulloreve financiare.- Është draftuar Rregulla Financiare për Monitorim të Organizatave Buxhetore dhe gjatë vitit 2019 do të finalizohet. Pas hyrjes në fuqi të rregullores do fillohet monitorimi dhe raportimi në baza tremujore për monitorimet, vonesat në pagesa, dhe respektimi i planit kontabël nga OB-të.

(2.2) Futja në përdorim e kontabilitetit të keshit të modifikuar në raportim.- Futja në përdorim e kontabilitetit të keshit të modifikuar në raportim është proces që do zgjasë për një periudhë së paku 5 vjeçare. Është aktivitet që Pikë Referuese ka për vitin 2020. Kjo pasi që për të vazhduar me ndryshimet në parimin e kontabilitetit, kërkohen ndryshime legjislative, ngritje e kapaciteteve profesionale të stafit dhe përshtatja e planit kontabël në SIMFK.

(2.3) Zgjerimi i funksioneve të SIMFK.- Thesari gjatë vitit 2018 ka filluar së implementuari arkivën elektronike ku OB-të me rastin e regjistrimit të shpenzimeve në SIMFK janë të obliguara të bashkëngjisin dokumentacionin e skanuar financiar. Gjatë vitit 2019 do avancohet si proces nën monitorimin e Thesarit të Kosovës dhe do vazhdohet me ruajtjen e dokumentacionit financiar nga OB-të.

(2.4) Zbatimi i Ligjit për Kontroll të Brendshëm të Financave Publike (KBFP).- Më 15,16,17 dhe 18 Prill 2019 në bashkëpunim me IKAP janë trajnuar 104 zyrtar të Subjekteve të Sektorit Publik (SSP) me temën "Raporti vjetor për funksionimin e KBFP" me theks të veçantë për kërkesat e reja nga Ligji për KBFP për standardin e raportimit dhe llogaridhënies. Sipas planit të trajnimeve, pasi që PVV është harmonizuar me kërkesat e Ligjit për KBFP, jemi në proces të përgatitjes së materialit për trajnim në K4. Për sa i përket Akteve të reja nën ligjore për zbatimin e Ligjit për KBFP:

- Është aprovuar Rregullorja MF - Nr. 01/2019 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin;
- Është rishikuar dhe aprovuar pyetësoni për vetëvlerësim sipas Ligjit për KBFP dhe Rregullores së re Nr. 01/2019 për MFK;
- Është aprovuar nga Qeveria, Rregullorja (QRK) Nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik;
- Është aprovuar nga Ministri i Financave, Udhëzimi Administrativ MF-Nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik.

Do të vazhdohet me zbatimin e këtyre rregulloreve në praktikë si dhe me mbajtjen e trajnimeve në K4 2019 për rreth 90 zyrtarë, konform planit të hartuar të trajnimeve.

(2.5) Monitorimi i kontrollit të brendshëm në OB.- Janë monitoruar dy (2) Subjekte të Sektorit Publik (SSP) dhe janë përfunduar raportet e monitorimit, ndërsa në proces të monitorimit janë dy (2) SSP, për të cilat do të përfundohen raportet në K3 2019. Përfundimi i dy monitorimeve të mbetura do të bëhet sipas planit të paraparë në K4.

(2.6) Zbatimi i përkrahimit të proceseve dhe standardit unik të menaxhimit të rrezikut.- Zbatimi i Përkrahimit të proceseve dhe të standardit unik të menaxhimit të rrezikut ka filluar të zbatohet në nivelin lokal. Ky aktivitet mbështetet nga Projekti i USAID (Transparency). Zbatimi ka filluar në pesë (5) pilot komuna - Prishtina, Peja, Gjakova, Ferizaj, dhe Prizren. Pas analizës së rezultateve të dalta nga Pilot Projektet, do të vazhdohet me komunat tjera.

(2.7) Hartimi dhe dërgimi për aprovim në Qeveri i Raportit të konsoliduar vjetor për sistemin e KBFP.- Nga 110 Subjekte të Sektorit Publik (SSP) pyetësonin e kanë plotësuar 107 SSP. Këtij procesi i ka paraprirë funksionalizimi i softuerit të pyetësonit vetëvlerësues. Ky softuer ka mundësuar SSP të plotësojnë pyetësonin on-line.

Gjatë gjashtë mujorit të parë janë pranuar dhe analizuar 69 raporte nga NJAB.

Gjatë muajit Qershor Raporti i konsoliduar vjetor për funksionimin e sistemit të KBFP-së (MFK+AB) për vitin 2018 është dërguar dhe aprovuar nga Ministri i Financave. Raporti vjetor më pas është dërguar dhe aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK). Do të përgatitet materiali për trajnim për Pyetësonët Vetë Vlerësues, i azhurnuar sipas Ligjit të KBFP.

(2.8) Hartimi i infrastrukturës ligjore për rregullimin e zotimeve tre-vjeçare.- Thesari ka testuar infrastrukturën në kuadër të SIMFK dhe përkrahjet zotimi i fondeve për periudhë 3 vjeçare, por duhet avancim në Ligjin e buxhetit duke saktësuar bazën ligjore për zotime tre vjeçare. Aktiviteti vlerësohet si sfidues.

Prioriteti 3: Mbledhja e qëndrueshme e të hyrave

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 3.1-3.7

Për arritjen e këtij qëllimi, strategjia ka grupuar shtatë (7) aktivitete. Lidhur me realizimin e këtij prioriteti, në krahasim me Pikat Referuese për vitin 2019 është evidentuar progres në zbatim tek të gjitha aktivitetet.

(3.1) Rritja e përmbushjes së deklaramit me kohë.- Aktualisht, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka në shfrytëzim modulën për Menaxhimin e mos-deklaruesve në TVSH, ndërsa shumë shpejt pritet që ky modul të zgjerohet edhe me lloje të tjera të tatimeve. ATK, ka funksionalizuar Njësinë për trajtimin e mos deklaruesve dhe deklaruesve me vonesë. Kjo njësi është e themeluar në kuadër të Departamentit për Regjistrim dhe Shërbim të Tatimpaguesve, me qëllim të ofrimit të shërbimeve për tatimpagues dhe ngritjes së nivelit të vetëdijes së tatimpaguesve për përmbushjen e detyrimeve në mënyrë vullnetare.

Më konkretisht, njësi është duke i trajtuar rastet si pastrimi i llogarive tatimore dhe menaxhimi i mos-deklaruesve dhe deklaruesve me vonesë, pranimit dhe shqyrtimit i kërkesave lidhur me Sistemin Elektronik EDI, rregullimin e gjendjes së tatimpaguesit aty ku të dhënat nuk janë procesuar në sistem, etj. Si hap i ardhshëm është kampanja sensibilizuese në përmirësimin e sjelljes së tatim-paguesve ndaj përmbushjes së obligimeve tatimore

(3.2) Vlerësimi automatik i rreziqeve për të mundur aprovimin e menjëhershëm dhe pagesën për TVSh të cilat janë me rrezik të ulët.- Gjatë periudhës Janar- Qershor/ 2018, kemi pasur gjendjen si më poshtë;

- numri i kërkesave të aprovuara ishte 162, nga kjo
 - o me vizitë të shkurtër 136
 - o me kontroll 26
- Mesatarja e ditëve për rimbursim ishte 30 ditë.

Krahasuar me vitin paraprak, për periudhën Janar- Qershor/ 2019, të dhënat tregojnë progres si më poshtë:

- numri i kërkesave on-line për TVSH përmes modulit të ri është 282 kërkesa,
- numri i kërkesave të aprovuara është: 172, apo dhjetë (10) më shumë, nga kjo:
 - o me vizitë të shkurtë 136, apo numër i njëjtë
 - o me kontroll 36, apo dhjetë (10) më shumë.
- Mesatarja e ditëve për rimbursim është 23 ditë, apo shtatë (7) ditë më herët.

Si hap i ardhshëm, ATK është në proces të rishikimit të kriterëve të veglës së Analizës së Rrezikut me qëllim të vlerësimit sa më të shpejtë dhe të saktë të kërkesave dhe të zvogëlohet numri i kërkesave për rimbursim të TVSh që trajtohen me kontrole tatimore. Këto vegla do të zbatohen përmes teknologjisë informative.

(3.3) Modernizimi i sistemit të teknologjisë informative.- Projekti është ende në fazën e vlerësimit (afër finalizimit), kështu që fillimi i implementimit pritet të bëhet pas nënshkrimit të kontratës. Kjo planifikohet të ndodhë gjatë pjesës së dytë të vitit 2019. Vlerësohet si aktivitet sfidues.

Pas Vlerësimit të ofertave të Operatorëve Ekonomik si dhe demonstrimeve të disa prej funksioneve të produkteve/zgjidhjeve të ofruara, Komisioni vlerësues dhe zyra e Prokurimit, do të dalin me një raport të vlerësimit më së largu deri në Nëntor 2019.

(3.4) Intensifikimi i aktiviteteve për luftimin e kontrabandës.- Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2019 është rritur numri i kontrolleve dhe patrullimeve. DK ka zhvilluar:

- 2814 Ndalesa rrugore (86.72% rritje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak)
- 1499 Patrullime (217.58% rritje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak)
- 219 Kundërvajtje (rritje 11% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit paraprak).

Dogana do të vazhdoj aktivitetet me qëllim parandalimin dhe zbulimin e rasteve të kontrabanduara.

(3.5) Luftimi i kontrabandimit të mallrave dhe lehtësimi i tregtisë.- Specifikat teknike për sistemin e kontrollimit me Barcode – RFID është përfunduar. Tenderi për furnizim me pajisje dhe implementim është shpallur nga ana e prokurimit. Aktualisht priten ofertat.

Në pjesën e dytë të vitit 2019 do të përfundohen procedurat tenderuese për Automatizimin e regjistrimit dhe kontrollit të transiteve përmes integritit të sistemit RFID (sistemi i monitorimit doganor).

(3.6) Ngritja e kapaciteteve në DK për mbledhje të qëndrueshme të të hyrave.- Gjatë periudhës raportuese janë trajnuar 117 zyrtarë doganor në fusha të ndryshme doganore si Tarifë, Origjinë, MSA etj. Në pjesën e dytë të vitit do të zhvillohen trajnimet sipas planit të trajnimeve.

(3.7) Ngritja e kapaciteteve në Departamentin e Tatimit në Pronë (DTP) në implementimin e Ligjit të ri Nr. 06/L-005 të Tatimit në Pronën e Paluajtshme.- Gjatë periudhës raportuese janë mbajtur punëtoritë më zyrtar të zyrave komunale të tatimit në pronë, me qëllim prezantimin e risive dhe reformave që mbart në vete Ligji i ri nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme. Në këto punëtori kanë marr pjesë përafërsisht 170 zyrtar, si menaxher të ZKTP-ve, operator, inkasant komunal etj.

Përveç kësaj në gjashtëmujorin e parë të këtij viti, si organizim i veçantë janë mbajtur trajnimet lidhur me Ligjin për Tatimin në Pronën e Paluajtshme me anketues të komunave (regjistruar të pronave të paluajtshme). Në këto trajnime kanë marrë pjesë afërsisht 135 zyrtarë (anketues). Këto punëtori dhe trajnime kanë pasur gjithashtu për qëllim edhe fuqizimin e zbatimit të ligjit.

Të hyrat nga tatimi në pronë gjatë periudhës Janar-Qershor 2019 kanë shënuar një rritje prej 1,264,691.00 Euro, apo 9% më shumë se sa në periudhën e njëjtë të vitit 2018. Sipas të dhënave të gjeneruara nga Sistemi i Tatimit në Pronë (STP) gjatë vitit 2018 në periudhën Janar-Qershor ishin inkasuar 12,559,135.48 Euro përderisa në periudhën e njëjtë të vitit 2019 janë inkasuar 13,823,826.48 Euro. Do të vazhdohet me sigurimin e inkasimit sipas planit.

Prioriteti 4: Zhvillimi i kornizës afatmesme të shpenzimeve (KASH)

Komente për statusin e arritjeve ne aktivitetet 4.1.-4.3

Për arritjen e këtij prioriteti janë planifikuar tri (3) aktivitete dhe në krahasim me Pikat Referuese për vitin 2019, është evidentuar progres në zbatimin e të tri aktiviteteve 4.1; 4.2; dhe 4.3; Për progresin e tërësishëm të këtij prioriteti do të raportohet në raportin vjetor.

(4.1) Fuqizimi i kapaciteteve për hartimin e vlerësimit të ndikimit buxhetor për nismat e reja qeveritare.- Për këtë gjashtëmuor janë këshilluar/trajnuar afër 50 zyrtarë të OB. Zyrtarët janë këshilluar në metodologjinë e Vlerësimit të Ndikimit Buxhetor (VNB) të nismave të reja qeveritare.

Në bashkëpunim me IKAP do të organizohen trajnime të vazhdueshme për shërbyesit civil të Organizatave Buxhetore për Metodologjinë e Vlerësimit të Ndikimit Buxhetor (VNB). Kjo me qëllim të ngritjes së vazhdueshme të kapaciteteve në këtë fushë.

(4.2) Avancimi i dokumenteve planifikuese (SKZH-Strategji Sektoriale - KASH).- Është siguruar harmonizim i sektorëve të KASH-it me Strategjinë Kombëtare Zhvillimore (SKZH). Tashmë OB-të janë të obliguara që në kërkesat e tyre të i japin prioritet masave dhe aktiviteteve të cilat janë të parapara në SKZH.

KASH-i është hartuar në bazë të Deklaratës së Prioriteteve të Qeverisë, pra OB-të kanë qenë të obliguara që në planifikimin e buxheteve të tyre me KASH të ju jepet prioritet Deklaratës së Prioriteteve të Qeverisë. Këto të dhëna kërkohen edhe me instruksionin e lëshuar nga MF për përgatitjen e KASH nga OB.

Në periudhën e ardhshme do të sigurohemi që OB të vazhdojnë ti zbatojnë me përpikëri instruksionet që lëshohen nga MF për përgatitjen e KASH, dhe të jenë në harmoni të plotë me SKZH dhe me Deklaratën e Prioriteteve të Qeverisë.

(4.3) Vlerësimi i ndikimit të politikave të propozuara me ndikim fiskal në të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.- Gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur iniciativa të reja fiskale, andaj edhe nuk ka pas opinion të vlerësimit të ndikimit në të hyra.

Me qëllim të shtimit të kontrollit, në opinionet e vlerësimit të ndikimit buxhetor kërkohet si shtesë edhe deklarimi lidhur me korrektësinë e paraqitjes së të dhënave nga ana e OB në formular të VNB. Në rast se vërehen mospërputhje të të dhënave, do të kërkohen informata shtesë nga OB në lidhje me këto mospërputhje të paraqitura në formularin e VNB. Do të realizohen sipas nevojës vlerësimet e ndikimit buxhetor të politikave të reja fiskale.

Prioriteti 5: Besueshmëria dhe kontrolli i ekzekutimit të buxhetit vjetor

Komente për statusin e arritjeve në aktivitetet 5.1-5.2

Për arritjen e këtij prioriteti janë planifikuar dy (2) aktivitete dhe në këtë periudhë të raportimit gjashtëmujor nuk kemi progres. Pritet që në pjesën e dytë të vitit të intensivikohen aktivitetet, sidomos tek pjesa e ngritjes së kapaciteteve.

(5.1) Zbatimi i Udhëzimit Administrativ (UA) për transferimet - ri-alokimet.- Udhëzimi Administrativ për transfere dhe rialokime është hartuar nga GP. Për shkak të ndërlidhjes me Ligjin e Buxhetit, pritet të aprovohet nga Ministri për të hyrë në fuqi në vitin 2020.

Pritet që së shpejti të aprovohet nga Ministri Udhëzimi Administrativ (UA) për transferimet - ri-alokimet, dhe të filloj zbatimi i tij në kuadër të Buxhetit 2020. Pas aprovimit të UA do të fillojnë edhe trajnimet për zyrtarët e OB, që planifikohet të mbahen në K4 2019.

(5.2) Hartimi i dokumentit analitik për menaxhimin e performancës. Nuk ka zhvillime lidhur me hartimin e Dokumentit analitik për menaxhimin e performancës, andaj edhe vlerësohet si sfidues për periudhën e ardhshme. Si hap i ardhshëm pritet të formohet grupi punues për hartimin e Dokumentit analitik për menaxhimin e performancës.

Prioriteti 6: Cilësia e informatave të buxhetit kapital

Komente për statusin e arritjeve në aktivitetet 6.1.-6.3

Për arritjen e këtij Prioriteti janë planifikuar tri (3) aktivitete dhe në krahasim me Pikat Referuese për vitin 2019, është evidentuar progres në të tri aktivitetet. Aktivitetet 6.1 dhe 6.3 janë në proces dhe pritet finalizimi i tyre deri në fund të vitit 2019. Prandaj për progresin e tërësishëm të tyre do të raportohet në raportin vjetor.

(6.1) Aprovimi i udhëzimit administrativ (UA) për kriteret përzgjedhëse dhe prioritizimin e projekteve kapitale.- Udhëzimi Administrativ për kriteret përzgjedhëse dhe prioritizimin e projekteve kapitale është hartuar nga GP. Për shkak të ndërlidhjes me Ligjin e Buxhetit, pritet të aprovohet nga Ministri për të hyrë në fuqi në vitin 2020.

Me aprovimin e Udhëzimit Administrativ për kriteret përzgjedhëse dhe prioritizimin e projekteve kapitale nga Ministri, do të filloj zbatimi i tij në kuadër të Buxhetit 2020. Pas aprovimit të këtij UA do të fillojnë edhe trajnimet për zyrtarët e OB. Planifikohen të mbahen në K4 2019.

(6.2) Organizimi i trajnimit për sistemin PIP (trajnimi i zyrtarëve të rinj si dhe rifreskimi i njohurive të zyrtarëve ekzistues) - Gjatë periudhës raportuese janë trajnuar 24 zyrtarë për përdorimin e sistemit të PIP për nivelin qendror. Ndërsa për nivelin lokal është planifikuar që trajnimet të mbahen në muajin Gusht 2019.

Nëse paraqitet nevoja për trajnime në pjesën e dytë të vitit, DB është i gatshëm të mbaj trajnime për PIP. Për nivelin komunal është e planifikuara të mbahen trajnime në muajin Shtator.

(6.3) Aprovimi i Udhëzimit Administrativ (UA) për definimin e projekteve kapitale.- Udhëzimi Administrativ për definimin e projekteve kapitale është hartuar nga GP. Për shkak të ndërlidhjes me Ligjin e Buxhetit, pritet të aprovohet nga Ministri për të hyrë në fuqi në vitin 2020.

Pritet që së shpejti të aprovohet nga Ministri Udhëzimit Administrativ për definimin e projekteve kapitale dhe të filloj zbatimin e tij në kuadër të Buxhetit 2020. Pas aprovimit të tij, do të fillojnë edhe trajnimet për zyrtarët e OB. Trajnimet planifikohen të mbahen në K4 2019.

SHTYLLA 3: EFIKASITETI OPERACIONAL

Prioriteti 7: Prokurimi Publik

Komente për statusin e arritjeve në aktivitetet 7.1-7.6

Për arritjen e këtij prioriteti janë planifikuar gjashtë (6) aktivitetet dhe në krahasim me Pikat Referuese për vitin 2019 është evidentuar progres në zbatimin e pesë (5) aktivitetëve, ndërsa aktiviteti 7.6, pritet të zbatohet sipas planit deri në fund të vitit.

(7.1) Zhvillimi i procedurave të centralizuara.- Udhëzimi Administrativ (UA) për prokurimet e centralizuara për vitin 2019 është aprovuar në Qershor 2019. Një progres i theksuar është arritur me zbatimin e kontratave të centralizuara dhe në kursime buxhetore. Vlen të theksohet se MF vetëm për një vit ka shpenzuar për furnizim me toner (duke përjashtuar furnizimin me aparate fotokopjuese, Printer dhe Skaner dhe servisimin e tyre) mbi 100.000 euro. Ndërsa lidhur me kontratën e AQP mbi shërbimet e kopjimit skanimit dhe printimit shpenzimet vjetore janë rreth 15.000 euro. Raste të ngjashme kursimi kemi edhe tek Autoritetet tjera Kontraktuese (AK).

Sipas UA të prokurimit të centralizuar, do të rritet lista e prokurimeve të centralizuara.

(7.2) Fuqizimi i AQP me personelin e nevojshëm dhe ngritja e kapaciteteve profesionale.- AQP në periudhën raportuese Janar Qershor ka punësuar tre zyrtar të rinj. Nuk ka pasur aktivitetet trajnuese.

Si hap i ardhshëm, AQP do të kompletohet me staf, pasi pjesa tjetër prej tre zyrtarëve do të përzgjidhen deri në fund të vitit.

(7.3) Avancimi dhe fuqizimi i sistemit të e-prokurimit në kryerjen e aktivitetëve të prokurimit.- Gjatë kësaj periudhe, me qëllim të funksionimit më të mirë të platformës së prokurimit elektronik është bërë edhe një plotësim-ndryshime i Rregullave dhe

Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP). RRUOPP, me plotësim/ndryshimet e bëra ka hyrë në fuqi më 16.04.2019.

Një progres i theksuar është arritur me zbatimin e e-prokurimit nga të gjitha AK dhe për të gjitha llojet e kontratave (duke përjashtuar ato me vlera minimale). Nga 1 Janari 2019, është bërë obligative dorëzimi i ofertave në formë elektronike nga operatorët ekonomik gjatë pjesëmarrjes në aktivitetet e prokurimit edhe për kontratat në vlera të mëdha. Zbatimi i e-prokurimit nga AK, ka ngritur efikasitetin, konkurrencën dhe transparencën gjatë zhvillimit të aktiviteve të prokurimit nga AK, në nivel të vendit.

(7.4) Monitorimi gjithëpërfshirës i ciklit të aktiviteve të prokurimit publik me qëllim uljen e numrit të aktiviteve të anuluar.- KRPP, gjatë kësaj periudhe raportuese ka bërë monitorimin e aktiviteve të prokurimit të ngritura dhe të publikuara në platformën e e-prokurimit. Janë monitoruar gjithsej 224 njoftime për anulim të aktiviteve të prokurimit, e dhënë kjo e përfshirë edhe në raportin e punës së Departamentin të Monitorimit të KRPP për gjashtëmujorin e parë të 2019, me të dhëna më të detajuara në lidhje me këtë çështje. Gjithashtu, janë monitoruar edhe lloje të tjera të njoftimeve gjatë implementimit të aktiviteve të prokurimit nga AK. Janë kryer edhe monitorime të aktiviteve të prokurimit sipas kërkesave të operatorëve ekonomik dhe palëve të tjera të interesuara.

Me qëllim që të bëhet evidentimi, parandalimi dhe eliminimi i lëshimeve eventuale që kanë të bëjnë me respektimin e ligjit të prokurimit publik nga Autoritetet Kontraktuese (AK), ngritjes së nivelit të punës me qëllim të shfrytëzimit të drejtë, transparent dhe efikas të fondeve publike, KRPP do të vazhdoj me monitorim gjithëpërfshirës të ciklit të aktiviteve të prokurimit të implementuara nga AK, në nivel të vendit.

(7.5) Ndryshimet ligjore në sistemin e Prokurimit Publik.- Për shkak të nevojave të paraqitura, KRPP ka filluar me inicimin e ndryshimeve të LPP. Përmes këtij ndryshimi do të inkorporohen dispozitat e Direktivave të reja të Prokurimit të BE-së, të kompletohet baza për funksionimin e mirëfilltë të platformës së prokurimit elektronik, të definohen mundësitë për NVM për pjesëmarrje në aktivitete të prokurimit, si dhe të eliminohen të gjitha vështirësitë që janë hasur gjatë zbatimit të Ligjit në praktikë. Me vendim të MF të datës 21.01.2019, është themeluar grupi i punës për hartimin e Koncept Dokumentit (KD), për trajtimin e legjislacionit në fushën e prokurimit publik. Janë mbajtur në vazhdimësi takime të grupit punues si dhe takimi publik.

Në pjesën e dytë të vitit, draft Koncept Dokumenti (KD) i hartuar, do të përkthehet në gjuhët zyrtare dhe do të dërgohet për konsultime ndër-institucionale dhe publike. Pas kësaj do të vazhdohet me procedurën për dorëzim në Qeveri për aprovim. Hartimi i KD për trajtimin e legjislacionit për prokurim publik, pritet të finalizohet dhe aprovohet në periudhën K3-K4, 2019.

(7.6) Trajnimi i zyrtarëve të prokurimit publik në nivel bazik dhe të avancuar.- Gjatë periudhës raportuese, nuk ka pasur trajnime në fushën e prokurimit publik dhe vlerësohet si sfidues. Trajnime të nivelit të avancuar si dhe atij bazik janë planifikuar të zhvillohen në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2019.

Programi i trajnimit të avancuar i 424 zyrtarëve të prokurimit që kanë certifikatë themelore në fushën e prokurimit publik do të fillojë në Shtator të 2019. Si rezultat, 424

zyrtarët e prokurimit që kanë certifikatë themelore në prokurimin publik dhe e cila ka vlefshmëri deri në fundin e vitit 2019, do të pajisen me certifikatë të avancuar. KRPP, sipas kërkesave të paraqitura nga zyrtarët e prokurimit dhe personat e tjerë të interesuar, do të mbajë trajnim themelor profesional për prokurim publik për vitin 2019. Numri i zyrtarëve të prokurimit dhe personave të tjerë të interesuar të cilët pritet të pajisen me certifikatë themelore është 30-40.

Prioriteti 8. Fuqizimi i Auditimit të Brendshëm

Komentet për statusin e aktiviteteve 8.1 – 8.3

Për arritjen e prioritetit “Fuqizimi i auditimit të brendshëm” me planin e rishikuar janë planifikuar tri (3) aktivitete që ndërlidhen me fuqizimin e auditimit të brendshëm si parakusht për shtimin e vlerës ndaj menaxhimit llogaridhënës. Në krahasim me Pikat Referuese për vitin 2019, është evidentuar progres në zbatimin e të tri aktiviteteve. Aktivitetet 8.1 tashmë ka arritur Pikën e Referimit.

(8.1) Harmonizimi i metodologjisë për monitorimin e NjAB me kërkesat e reja të Ligjit për KBFP.- Metodologjia për monitorimin e NjAB është harmonizuar me kërkesat e reja të Ligjit për KBFP dhe akteve nënligjore dhe e njëjta është duke u zbatuar.

(8.2) Monitorimi i Njësive të auditimit të brendshëm.- Janë monitoruar tetë (8) NjAB dhe një (1) NjAB është në proces të monitorimit.

Në periudhën e ardhshme do të vazhdohet me monitorimin edhe të dy NjAB.

(8.3) Hartimi i planit të trajnimit për auditorët e brendshëm dhe organizimi i trajnimeve sipas planit.- Është organizuar Konferenca për 'Fuqizimin e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike - llogaridhënia menaxheriale". Panelistë në konferencë ishin: Ministri i Financave, Drejtori i Buxhetit të Përgjithshëm nga Brukseli, Auditori i Përgjithshëm, Përfaqësuesit nga SIGMA dhe Drejtori i NjQH. Në konferencë kanë marrë pjesë 174 pjesëmarrës. Në mesin e tyre edhe 12 anëtarët e stafit të NjQH.

Në bashkëpunim me IKAP-in është organizuar seminari për 160 anëtarë të komitetit të auditimit me temën "Roli i komiteteve të auditimit".

Gjithashtu është organizuar provimi me shkrim dhe me gojë për auditorët e brendshëm. Programin për certifikim të auditorëve të brendshëm e kanë përfunduar me sukses 32 kandidatë. Kandidatët e suksesshëm janë pajisur me certifikatë kombëtare për auditim të brendshëm.

Në bashkëpunim me USAID-in janë organizuar dy punëtori për nivelin komunal ku kanë marrë pjesë 50 pjesëmarrës. Në këto punëtori është trajtuar sigurimi i cilësisë dhe rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

Prioriteti 9: Fuqizimi i auditimit të jashtëm

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 9.1-9.6

Për arritjen e prioritetit “Fuqizimi i auditimit të jashtëm” janë planifikuar gjashtë (6) aktivitete që ndërlidhen me fuqizimin e auditimit të jashtëm përmes zhvillimit të institucionit suprem të auditimit që funksionon mirë, kryen auditime në përputhje me standardet e auditimit të sektorit publik të pranuar ndërkombëtarisht. Në krahasim me Pikat Referuese për vitin 2019 është evidentuar progres në zbatimin e të gjithave aktiviteteve. Për më shumë aktiviteti 9.3 është përfunduar.

(9.1) Ruajtja e pavarësisë institucionale. ZKA ka hartuar draftin e parë të ndryshim/plotësim të Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit 05/L-055. Drafti është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditori i Përgjithshëm ka adresuar te Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP), nevojën për ndryshim/plotësim të Ligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit 05/L-055. Për këtë qëllim është themeluar një grup punues, i cili ka identifikuar çështjet me rëndësi për adresim dhe ka nxjerrë një koncept dokument me sqarimet e nevojshme. Ky dokument është qarkulluar tek grupi menaxhues i ZKA-së për komente dhe ditëve në vijim do të diskutohet më gjerësisht.

Si hap i ardhshëm, Koncept Dokumenti do t’i dërgohet Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike respektivisht Kuvendit për veprim të mëtutjeshëm sipas përgjegjësisë.

(9.2) Avancimi i metodologjisë së auditimit, përmes automatizimit.- Ka filluar përgatitja për softuerin e auditimit. Deri më tani kanë përfunduar fazat përgatitore si studimi i fizibilitetit, MAP-ingu dhe hartimi i termeve të referencës. Aktualisht, softueri i auditimit është në proces të tenderimit.

Sa i përket trajnimit të stafit për përdorim të softuerit, do të bëhet pas përfundimit të fazës së zbatimit (implementimi) të tij.

(9.3) Përditësimi i Udhëzuesit për Auditime të Rregullsisë.- Është bërë përditësimi i Doracakut të auditimeve të rregullsisë, ku është vendos kapitulli për auditime financiare të Ndërmarrjeve Publike, i cili ka filluar të zbatohet nga shtatori i 2018. Është hartuar draft Doracaku për auditime të pajtueshmërisë, në bazë të cilit janë kryer tri pilot auditime të pajtueshmërisë dhe gjatë Shtatorit të këtij viti presim aprovimin e tij.

Udhëzuesi për menaxhimin e cilësisë është në pajtim me SNISA dhe sipas nevojës në fillim të sezonit të auditimit 2019/2020 do të bëhet përditësimi i tij.

Në periudhën e ardhshme të raportimit pritet aprovimi i Doracakut për auditime të pajtueshmërisë.

(9.4) Zhvillimi i mëtejshëm i praktikës së auditimit të performancës së ZKA. Pako e letrave të punës të auditimeve të performancës është përditësuar, ndërsa përditësimi i manualit të auditimit të performancës është në proces. Në kuadër të zhvillimit të praktikës së auditimit të performancës është hartuar udhëzuesi për përcjelljen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Auditimet e performancës janë duke u

publikuar sipas planit. Për periudhën Janar – Qershor 2019 janë publikuar 4 auditime të performancës:

1. Prokurimet me procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë.
2. Zhvillimi i Kapaciteteve në Procesin e Bërjes së Politikave dhe Koordinimit;
3. Procesi i menaxhimit të granteve dhe subvencioneve në sektorin e bujqësisë;
4. Efektet e ndarjes së tenderëve në lloje.

(9.5) Përfshirja e Kuvendit në shqyrtimin e raporteve të Auditimit.- Me qëllim të fuqizimit të bashkëpunimit mes Parlamenteve dhe Institucioneve Supreme të Auditimit për përmirësimin e performancës së auditimit të jashtëm, janë organizuar dy Konferenca Rajonale ku pjesëmarrës kanë qenë përfaqësuesit nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike (KMFP), Komisioni për Buxhet dhe Financa (KBF) si dhe përfaqësues nga ZKA. Me datë 07 Maj 2019 është mbajtur Konferenca Rajonale “Mbikëqyrja Parlamentare e Financave Publike” e organizuar nga Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike në bashkëpunim me GIZ. Ndërsa, më datë 9-10 Maj në Tiranë, u mbajt Konferenca Rajonale e Institucioneve Supreme të Auditimit dhe Rrjetit të Komisioneve Parlamentare për Ekonomi, Financa, dhe Integritet Evropian të Ballkanit Perëndimor, organizuar nga Banka Botërore dhe OECD/SIGMA.

Po ashtu, me kërkesë të Komisioneve Parlamentare (KMFP dhe KBF) dhe përkrahje nga GIZ, është mbajtur një takim mes anëtareve të Komisioneve dhe përfaqësuesve nga ZKA për të diskutuar në lidhje me përmbledhjet e raporteve të auditimit të ZKA për Komisionet parlamentare, më konkretisht përgatitja e materialeve për trajtimet e Raporteve të auditimit.

KMFP, gjatë periudhës Janar-Qershor, ka mbajtur gjithsej tetë (8) mbledhje ku janë shqyrtuar pesë (5) raporte të auditimit. Ndërsa KBF, në rastet kur ka shqyrtuar raportet financiare të OB, ka ftuar përfaqësues të ZKA-së për të prezantuar raportet e auditimit.

Si hap i ardhshëm do të vazhdohet komunikimi me komisionet përkatëse parlamentare me qëllim të koordinimit më të mirë për trajtimin e Raporteve të Auditimit. Përmes komunikimit të vazhdueshëm dhe përkrahjes së komisioneve parlamentare, ZKA synon të rris numrin e trajtimeve të Raporteve të auditimit në Kuvend dhe rritjen e shkallës së rekomandimeve të adresuara përkatësisht zvogëlimin e shkallës së rekomandimeve të pa adresuara.

(9.6) Mbikëqyrja/Përcjellja e zbatimit të rekomandimeve të ZKA-së.- Është përgatitur Raporti gjashtëmuor i planit të zbatimit të rekomandimeve të ZKA 2017 dhe është dërguar në Qeveri. Qeveria e Republikës së Kosovës (QRK) me vendimin nr. 08/69, datë 16.10.2018, ka aprovuar planin e veprimit për zbatim të rekomandimeve të Raportit Vjetor të Auditimit për vitin 2017 (RVA 2017). Ky vendim kërkon proces të raportimit dy herë në vit për statusin e adresimit/implementimit të rekomandimeve të dala nga RVA 2017. Ministria e Financave/Thesari i Kosovës përmes shkresës zyrtare ka kërkuar nga OB-të përkatëse të raportojnë për statusin e implementimit të rekomandimeve.

Ministria e Financave/Thesari i Kosovës do të kërkoj nga Zyrtarët Kryesor Administrativ të OB-ve përkatëse që sipas përgjegjësisë për implementim të rekomandimeve të raportojnë për statusin e implementimit në mënyrë që Qeveria të ketë në shqyrtim edhe

raportin e dytë në janar 2020 sipas planit të veprimit të aprovuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me vendimin nr. 08/69, datë 16.10.2018.

SHTYLLA 4: ÇËSHTJET E NDËRLIDHURA TË MFP

Prioriteti 10: Përmirësimi i sistemeve të TI

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 10.1-10.2

Për arritjen e prioritetit “Përmirësimi i sistemeve të TI” janë planifikuar dy (2) aktivitete që ndërlidhen me përmirësimin e sistemeve të TI-së si faktor i rëndësishëm në përmirësimin e informatave financiare për menaxhimin e financave publike. Në krahasim me Pikat Referuese për vitin 2019 është evidentuar progres në zbatimin e të gjithave aktiviteteve.

(10.1) Integrimi i sistemeve të TI në MF dhe agjencitë e saja vartëse- Integrimi i sistemeve në MF dhe Agjencitë e saj vartëse ka përfunduar dhe është funksional. Si shembull kemi ndërlidhjen e sistemit të tatimit në Pronë dhe Thesarit, ku kemi regjistrimin e pagesave të tatimit në pronë në mënyrë automatike falë ndërlidhjes së sistemit të Departamentit të Tatimit në Pronë (DTP) me Thesarin . Zhvillimi i DWH (Data warehouse) dhe sistemit raportues (BI-Business Intelligence) është në vijim e sipër. Në bashkëpunim me akterët relevant është bërë definimi i kërkesave për të dhënat e nevojshme që duhet të jenë pjesë e deponisë së të dhënave. Po ashtu është bërë edhe dizajnimi i Data Warehouse. Gjithashtu është bërë edhe zhvillimi i sistemeve ekzistuese si p.sh. BDMS me modulën e ri të dalë nga Ligji i Pagave.

Procesi zhvillohet në vazhdimësi në bazë të kërkesave shitesë të Departamenteve. Në periudhën e ardhshme do të bëhet zhvillimi i data bazës së DWH, zhvillimi i aplikacionit të DWH si dhe testimi i tij.

(10.2) Krijimi i qendrës së të dhënave financiare (Disaster Recovery System).- Gjatë periudhës raportuese janë siguruar pajisjet harduerike për Disaster Recovery. Janë instaluar, konfiguruar dhe të njëjtat janë operacionale. Aktualisht jemi duke testuar replikimin e të dhënave. Gjatë tremujorit të tretë pritet simulimi i qendrës së rimëkëmbjes për të vazhduar tutje me sinkronizim me kapacitete të plota.

Deri në fund të vitit 2019 do të bëhet sinkronizimi i plotë i ruajtjes së të dhënave financiare edhe në këta server.

Prioriteti 11: Transparenca për buxhetin

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetet 11.1-11.4

Për arritjen e prioritetit në lidhje me "Sigurimin e pajtueshmërisë së informatave për Buxhetin e Kosovës me FMN/standardin GFSM 2014" janë planifikuar katër (4) aktivitete që ndërlidhen me rritjen e transparencës buxhetore si parakusht për shtimin e vlerës ndaj menaxhimit llogaridhënës. Në krahasim me Pikat Referuese për vitin 2019, është shënuar progres i kënaqshëm në zbatimin e të gjitha aktiviteteve (11.4-11.4), ndërsa vlen të theksohet se aktiviteti 11.3 është finalizuar me publikimin e Dokumentit të Buxhetit Miqësor në Prill 2019.

(11.1) Modifikimi i SIMFK për ta mundësuar përgatitjen e automatizuar të raporteve të buxhetit në pajtim me GFSM 2014.- Raportimi sipas GFSM 2014 është bërë gjatë vitit 2018 dhe atë në nivel të avancuar të shpeshësisë së raportimit nga vjetore në tremujore që ndryshe njihen si raportime "High frequency". Janë krijuar formula specifike për gjenerimin e raporteve kristale në SIMFK sipas kërkesave nga fusha e raportimeve, të cilat shërbejnë për raportim sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS) dhe GFSM 2014.

Do të vazhdohet me publikimin dhe përcjelljen e trendeve raportueses duke vazhduar me përmirësimin e cilësisë së kodifikimeve sipas GFSM 2014.

(11.2) Rishikimi i planit kontabël të Qeverisë - Gjatë vitit 2019 është planifikuar që diagrami i llogarive gjegjësisht plani kontabël të rishikohet sipas kërkesave të reja të IPSAS në pjesën e dytë të vitit. Klasifikimi i saktë dhe respektimi i planit kontabël është edhe rekomandim i auditimit, andaj gjatë vitit 2019 do të jetë në fokus edhe i buxhetimit. Pas rishikimit do të filloj ngritja e kapaciteteve. Vlerësohet si aktivitet sfidues për tu arrit deri në fund të vitit.

Si hap i ardhshëm, planifikimi i buxhetit 2020 do të reflektoj kërkesën për klasifikim dhe zbatim të saktë të rregullores për planin kontabël.

(11.3) Hartimi i Dokumentit të Buxhetit Miqësor (Narrativ).- Edhe në këtë vit, MF ka hartuar Dokumentin e Buxhetit Miqësor (Narrativ) për vitin 2019 në të tri gjuhët. Ky dokument është publikuar në ueb faqen e MF-së në Prill 2019. Buxheti miqësorë për vitin 2020 pritet të hartohet dhe publikohet pas hyrjes në fuqi të Ligjit të Buxhetit për vitin 2020.

(11.4) Raportimi i rregullt financiar për ekzekutimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës. Gjatë vitit 2019 është përgatitur Raporti Vjetor Financiar për vitin 2018, Raporti tremujor dhe gjashtëmujor i buxhetit 2019. Raportimi është duke u bërë në vazhdimësi në Portalin e Transparencës.

Prioriteti 12. Ngritja e qëndrueshme e kapaciteteve në MFP

Komenti për statusin e arritjeve në aktivitetin 12.1

Për arritjen e prioritetit në lidhje me ngritjen e qëndrueshme të kapaciteteve në MFP janë ndërmarr disa iniciativa, të cilat nuk kanë rezultuar me zbatimin e studimit të Fizibilitetit, i cili do të ofronte zgjidhjen më të mirë për këtë Prioritet. Vlen të theksohet se mjetet janë siguruar, por pritet që të kompletohet dokumentacioni tenderues dhe të tenderohet kërkesa për studim të fizibilitetit. Vlerësimi i nevojave për trajnim në fushën e MFP-së parashihet të realizohet si pjesë e studimit të fizibilitetit.

12.1 Zhvillimi i studimit të fizibilitetit mbi Qendrën e Trajnimeve për MFP, përfshirë vlerësimin e nevojave për trajnime.- Mjetet për zhvillimin e Studimit të fizibilitetit janë ndarë nga Buxheti i Kosovës. Ka filluar zhvillimi i dokumentacionit relevant për tenderim. Për shkak të mungesës së kapaciteteve dhe kohës, pas disa takimeve me zyrtarin e Prokurimit, nuk ka pas mundësi të zhvillohet dokumentacioni tenderues, andaj vlerësohet si sfidues. Është duke u analizuar mundësia që përmes LuxDev të angazhohet një ekspert për hartimin e dosjes së tenderimit.

Si hap i ardhshëm do të adresohet kërkesa në LuxDev me qëllim të aprovimit të mbështetjes me ekspert të prokurimit, i cili do të hartonte dokumentacionin e nevojshëm për tenderim të kërkesës për Studim të Fizibilitetit.